



Funded by
the European Union



Moduli pirografi

KAPITULLI 1 Njohja dhe përdorimi i mjeteve të punës dhe lënda e parë

1. Njohuri kulturore mbi artizanatin tradicional
2. Arti i pirografisë
3. Llojet e artizanatit
4. Teknologjia dhe Mjedisi
5. Njohja me lëndën e parë dhe mjetet e punës
6. Mësimi i përdorimit të veglave të punës
7. Si përdoren mjetet e punës
8. Siguria në punë, rreziqet
9. Kontrolli dhe mirëmbajtja e pajisjeve dhe vendit të punës – Këshilla

KAPITULLI 2 Teknikat e vizatimit dhe realizimi i një motivi të thjeshtë

1. Shpjegimi i vizatimit
2. Stampimi
3. Linjat
4. Format
5. Vlerat (dritëhijet)
6. Theksi
7. Pirografi – akwareli, tempera
8. Përdorimi i fotografive si model për të djegur në dru

KAPITULLI 3 Teknikat e prodhimit

- ✘ Prgatitja e drurit
- ✘ Transferimi i modelit në dru
- ✘ Si të kontrollohen tonet e errëta dhe të lehta
- ✘ PuniMI me shtresa
- ✘ Shkurtimi

- ✘ “Fshirësi magjik”
- ✘ Finalizimi i punës suaj.
- ✘ Dhënia e dorës së fundit.
- ✘ Përdorimi i ngjyrave në pirografi – Djegia e drurit me ngjyra
- ✘ Mundësitë për të shtuar ngjyra.

KAPITULLI 1 NJOHJA DHE PËRDORIMI I MJETEVE TË PUNËS DHE LËNDA E PARË

NJOHURI KULTURORE MBI ARTIZANATIN TRADICIONAL

Punimi i drurit kudo e pati zanafillën e rrugën e zhvillimit si një art baritor. Shumë objekte të vogla prej druri si kërraba e bariut, luga, furka, kuti duhani, lahuta, çifteli, fyej, kavallë, cyle një e dyjare, krehëra, stola, karriga, djepa, tabaka e kuti kafeje, rrathë kumbone të skalitura me me një mjeshtëri daltë artisti e shtëpiake, bëhej për të plotësuar nevoja të jetës familjare, duke shfrytëzuar kohën e lirë, sidomos në dimër kur njerëzit qëndronin në shtëpi; në ato raste bënin arka grash, tavane, dollape muri, korniza dritaresh, dyer e rafte, voza, enë e orendi të ndryshme të jetës familjare; punimet i zbukuronin me motive të frymëzuara nga natyra e dukurive etnografike të krahinës ose simbole të mitologjisë popullore shqiptare; paraqitnin në këto zbulurime: lule, gjethe, bimë e drunj të natyrës, gdhenden aty në relief pamjet e gjallesave që ishin më të dashura për ta si: sorkadhja, dhia e egër, gjarpëri, dashi, kau, kali, dielli, hëna, yjet, bariu i shenjtë, përfytyrime të ndryshme mitike. Diku kemi simbole të virtyeteve të Shqiptarit, si mikpritja, trimëria, e shpirti luftarak i Shqiptarit, simbole kombëtare. Arti i Pirografisë në Mirdite e gjejmë tek veglat muzikore duke krijuar elemente zbulurimi. Gjithashtu gjendet tek orenditë shtëpiake, tek dollapet, arkat e drurit (arka e gjyshes) duke përdorur element dekorativ dhe zbulurues të ndërlidhura me modelet e ornamenteve të veshjeve tradicionale.

Tradita e punimit dhe e zbulurimit të objekteve të vogla prej druri nga vetë fshatarët për nevojat shtëpiake është ruajtur e gjallë edhe në shekullin tonë. Motivet e përdorura në përgjithësi janë të stilit gjeometrik, motive me origjinë të lashtë të ngjashme me motive të përdorura në artin ilir. Në disa krahina të vendit gdhendja e drurit arriti të ngrihej në një mjeshtëri të vërtetë arti. Në ekzemplarët e ikonostasëve të ruajtur dallohej qartë që sfondi vegjetal është mbizotërues ndërkohë që dallohen edhe kafshë reale, fantastike dhe zogj; luani, kuçedra, dreri, shqiponja me dy krerë, zogj të vegjël që çukasin lule, apo zogj që qëndrojnë përballë njëri-tjetrit, etj.

Punimi i metaleve paraqet gjithashtu një fushë me interes të artit popullor. Shume fise ilire kanë qenë punëtor të mirë të metaleve; dëshmojnë për këtë ornamentet e bukura prej bronxi, të gjetur në tumulet ilire. Në shekujt e fundit punime artistike metalesh kemi në objektet e thjeshta prej bakri si gjysma kusi, tenxhere, etj.. Por ka edhe objekte bakri të punuara me shumë shije artistike, si janë gjysmat e shek. XVII-XVIII nga Shqipëria e Jugut, sinitë ‘e shkrojtura’ të punuara në qytetet kryesore, ibrikë të ndryshëm etj.

ARTI I PIROGRAFISË¹

Çfarë është pirografia?

Pirografia (shkrimi me zjarr) është një art i vjetër i shkrimit me djegie të gjermave, simboleve dhe forma të ndryshme arti në dru ose sipërfaqe të tjera të cilat mund të skaliten me djegie. Edhe pse tradicionalisht janë përdorur mashat ose shkopinj djegës, rigjallërimi i saj vitet e fundit ka ndikuar në krijimin e një tregu për shitjen e një sërë pajisjesh për pifografi, apo krijimit të kurseve për pirografi.

Pirografia ashtu si dhe skulptura është një art që nuk i lejon gabimet në modelim, dhe me të drejtë quhet një art i vështirë pasi nuk mund t'i rregullojmë gabimet si në rastin e pikturës, dhe nëse gabojmë do të duhet ta flakim drurin. Në pirografi nuk ka një teknikë të veçantë ashtu sikurse pretendojnë pirografë të ndryshëm. Ajo çfarë është e rëndësishme është të vizatoni mirë. Do të duhet të përqëndroheni dhe të keni një dorë të qëndrueshme ose e thënë ndryshe të dini se sa forcë duhet ushtruar në pirograf. Këto janë edhe arsytet pse kaq pak njerëz merren me pirografi.

LLOJET E ARTIZANATIT²

Prodhimet e dorës, në të cilën mbizotëron tradita apo vlerat artistike, janë shprehje e formave të mëposhtme të artizanatit:

Artizanati tradicional

Mund të përkufizohet tradicional krijimi i një produkti në përputhje me teknikat dhe metodat e përcaktuara gjatë kohërave, sipas zakoneve dhe traditave në nivel lokal apo rajonal, në një kontekst të caktuar historik ose kulturor. Prandaj produkti duhet të bëhet me teknikat dhe mjetet që respektojnë me besnikëri modelet, format, stilet dhe dekoracionet gjetur e ruajtur në koleksionet publike dhe private dhe / ose në dispozicion nga burime dokumentare që kanë të bëjnë me trashëgiminë kulturore.

Artizanati artistik

Artizanati artistik është produkt unik apo me numër të kufizuar, në çdo material, i cili është i shkëlqyer nga pikëpamja teknike, duke respektuar rregullat dhe vlerat, ka një formë innovative autonome dhe dallohet nga bukuria estetike (përmasa, ngjyrat, detajet dekorative). Komunikimi i zgjedhjes stilistike dhe / ose shprehja e gjuhës së krijuesit të saj, është një shembull i përkujdesjes dhe saktësisë së traditës ose propozimit në një nivel eksperimental të procedurave të reja të realizimit.

Konceptimi dhe produkti mund të kryhet nga një zejtar, i çfarëdo arsimimi për artin përmes një shkolle apo trajnimit.

Prandaj janë konsideruar punime artistike produktet me vlerë të lartë estetike apo frymëzuar nga forma, modele, dekore, stile dhe teknika që përbëjnë tiparet tipike të trashëgimisë historike dhe kulturore duke marrë parasysh risitë në përputhje dhe respektim të traditës artistike.

¹ <http://earlswynn.hubpages.com/hub/The-Art-Of-Pyrography-Part-1-The-Basics>

² Disciplina di produzione (ex art. 15, l.r. 10/07)- Lavorazione artigianale dei metalli comuni

Artizanati inovativ

Mund të quhet inovativ realizimi i një produkti i cili paraqet më shumë ose më pak modifikime të thella në zgjedhjen dhe përdorimin e metaleve bazë dhe / apo lidhje metalike, të përpunuara në bazë të procedurave të veçanta, në vend të veçantisë së tyre estetike dhe funksionale, dhe / ose kritereve dhe / ose sistemeve të përdorura për të arritur atë, që përfaqësojnë elemente të reja në krahasim me të kaluarën.

Të gjithë produktet cilësorë të realizuara me metale tradicionale ose element të tjerë inovativë lidhen ngushtësisht me përkujdesjen me të cilën janë prodhuar, si dhe materialet e përzgjedhura, teknikat e përdorura, dhe sistemi i bashkimit të elementeve dhe dora përfundimtare.

Pjesa më e rëndësishme për krijimin e një produkti artizanal cilësor është puna manuale. Aftësia për të bërë punime me dorë është elementi kyç që dallon një punishte artizanale nga një sipërmarrje industriale; përgjatë fazës së kryerjes së një punimi aftësia e punës me dorë është element kryesor në garantimin e një pune cilësore. Aftësia dhe përvoja e artizanit janë të paçmueshme për të kryerjen e suksesshme të të gjitha fazave të punës dhe në realizimin e një produkti cilësor. Përdorimi i makinerive dhe instrumenteve teknologjike mund të ndihmojë në procesin e realizimit të produkteve artizanale cilësore, megjithatë mënyra origjinale e punimit tradicional duhet të ngelet e pacënuar.


Teknologjia dhe Mjedisi

Teknologjia është një koncept i gjerë që merret me aplikimin e njohurive për veglat dhe profesionet, në funksion të kontrollimit dhe përshtatjes së rrethanave në mjedisin jetësor në përputhje me nevojat e tij. Një përkufizim i saktë për termin "Teknologji" nuk ekziston. "Teknologjia" mund t'i referohet objekteve materiale që përdoren nga njeriu, siç janë makinat, hardwaret, por mund të përfshijë edhe tema më të gjera, përfshirë sistemet, metodat e organizimit, dhe teknikat.

Aplikimi i teknologjisë nga njerëzimi filloi me shndërrimin e resurseve natyrore në vegla të thjeshta.

Zbulimi i aftësisë së kontrollimit të zjarrit rriti burimet e ushqimit dhe zbulimi i rrotës i ndihmoi njerëzit të udhëtonin dhe të kontrollonin mjedisin e tyre.

Teknologjia ka ndikuar shoqërinë në mënyra të ndryshme. Në shumë shoqëri, teknologjia ka ndihmuar në zhvillimin e ekonomisë (përfshirë ekonominë globale të ditëve të sotme) dhe ka lejuar rritjen e klasës shoqërore të lirë (në aspektin e kohës dhe punës). Shumë procese teknologjike çlirojnë produkte të padëshirueshme, të njohura si ndotje, dhe harxhojnë burimet natyrore, në dëm të tokës dhe natyrës. Zbatimet e ndryshme të teknologjisë ndikojnë në vlerat e shoqërisë dhe një teknologji e re shpesh shtron pyetje të reja etike.



Ndikimi i shoqërisë në mjedisin gjeografik. Mjedisi gjeografik jo vetëm ndikon mbi shoqërinë njerëzore por edhe vetë i nënshtrohet ndikimit të shoqërisë. Shkalla dhe karakteri i veprimit të shoqërisë njerëzore varet nga niveli i zhvillimit të shoqërisë njerëzore. Mjedisi gjeografik përmban vlerat natyrore, të quajtura burime. Ato ndahen në burime të papërtëritshme, të përtëritshme e të pashtershme.

- Në burimet e papërtëritshme hyjnë mineralet e dobishme, shfrytëzimi i të cilave ka ardhur vazhdimisht në rritje. Sot në botë nxirren rreth 150 miliardë tonë minerale në vit. Nga përpunimi i mineraleve prodhohen mjaft mbeturina në gjendje të gaztë, të lëngët apo të ngurtë duke shkaktuar ndotjen e mjedisit. Në ditët e sotme në botë burimet e energjisë së papërtëritshme siç është energjia e lëndëve djegëse fosile si qymyrguri e nafta përbën pjesën dërrmuese (rreth 90 %) të energjisë së përdorur.
- Në burimet e përtëritshme hyjnë tokat, bota bimore dhe bota shtazore. Dallimi kryesor i burimeve biologjike nga ato minerale qëndron në faktin se të parat mund të pakësohen dhe të shterohen, ndërsa këto burime mund të rigjenerohen dhe të shtohen. Mjaft i rëndësishëm është aspekti kohor i rigjenerimit të tyre. Sipërfaqja e pyjeve është pakësuar shumë në ditët e sotme. Proçesi i shpyllëzimeve dhe djegiet, ripërtëritja e ngadaltë, incidentet e zjarreve të shumta kanë sjellë shkatërrimin e pyjeve.
- Në burimet e pashtershme mund të konsiderohen ajri, uji, si dhe energjia diellore, e erës, e baticë-zbaticës etj. Energjia e drejtëpërdrejtë diellore, hidrike apo eoliane përbën një burim të pashtershëm në ekuilibër që hyn në mënyrë të natyrshme në bilancin e planetit.

Si dhe pse duhet ta mbrojmë mjedisin?

Mjedisi në të cilin jetojmë është shumë i rëndësishëm. Ai është burim i jetës. Mbrojtja e natyrës dhe e mjedisit konsiderohen si pjesa më e rëndësishme e jetës në planetin tonë. Te gjitha proceset që çojnë në një sistem ekologjik të suksesshëm janë të lidhura me programin për përcaktimin e strategjisë dhe zhvillimin e mëtejshëm të objektivave në ruajtjen e natyrës e të mjedisit. Po të njiheshin mirë të gjitha këto probleme sot nuk do të kishim shqetësimet e ndotjes së ajrit, ujit të tokës apo efektet e ngrohjes globale.

Dy janë drejtimit kryesore:

1. Ruajtja e mjedisit që ka si qëllim të kufizojë ndikimin e ndotjeve të industrisë, bujqësisë, transportit, ndërtimit e të tjera veprimtari të njeriut.
2. Ruajtja e natyrës që ka si qëllim të kufizojë deri në minimum ndryshimet në natyrë (ekosistemet) siç janë efektet e ngrohjes globale, ruajtja e shtresës së ozonit, pakësimi i emetimit të gazrave, evitimi i shirave acide.


Parimet më të rëndësishme të mbrojtjes së mjedisit janë:

- Shfrytëzimi racional i burimeve, reduktimi i emetimeve në ajër, reduktimi i ndotjes së ujit dhe tokës, dhe riciklimi i mbeturinave;
- Ruajtja e vlerave biologjike-ekologjike të mjedisit nëpërmjet ruajtjes së florës dhe faunës, dhe të vlerave të trashëgimisë natyrore
- Mbështetja në përdorimin e burimeve të ripërtërishme, bashkë-prodhimin e këtyre burimeve dhe të llojeve të ndryshme të energjisë;
- Promovimi i kursimit të energjisë.
- Shfrytëzimi i pajisjeve shtëpiake me efikasitet të lartë, të tilla si llambat e dritës;
- Reduktimi dhe riciklimi i mbeturinave.

Ndikimi i teknologjisë dhe shkencës në mjedis

Në çdo proces teknologjik skema është e njëjtë kemi lëndën e parë që shfrytëzohet (material, energji,

Koncepti i teknologjisë bashkëkohore



ujë, etj) nëpërmjet një procesi dhe përftohet produkti si dhe prodhohen mbetje (të ngurta, të lëngëta dhe shkarkime në ajër). Të gjitha proceset prodhojnë mbetje. Kjo mbetje duhet minimizuar duke punuar si në drejtim të përdorimit më efikas të lëndës së parë por edhe të ripërdorimit apo riciklimit të mbetjeve për procese të tjera.

Si rezultat i proceseve të ndryshme teknologjike shkaktohet humbje e burimeve natyrore dhe ndotje në mjedis. Shkaktohet humbje e burimeve natyrore pasi njerëzit nuk janë racional dhe efektiv në planifikimet e

tyre. ***Ndaj dhe ju kur të kërkonte lëndën e parë duhet që ta grumbulloni atë nga biznese serioze dhe ekologjike, apo edhe nëse e merrni vetë në natyrë të zbatoni parimet e qëndrueshmërisë. Po ashtu mos harroni se nga çdo prodhim i juaji mund të gjenerohen mbetje të cilat duhet të hidhen në vendet e***

duhura. Por nëse gjatë proceseve të punës tuaj prodhohen mbetje që mund të ripërdoren për produkte më të vogla (psh në përmasa) apo nga artizan të tjerë atëherë ju duhet ta merrni në konsideratë një gjë të tillë.

Drejt një mjedisi të qëndrueshëm

Historia dëshmon për lidhje të fuqishme midis ndryshimeve në sistemet ekonomike dhe integritetit të sistemeve ekologjike. Industrializimi nxiti rritjen ekonomike dhe me industrializimin erdhën mbetjet dhe ndotja. Shumica e problemeve mjedisore rrjedhin prej fitimit tonë, përdorimi dhe dhënia e burimeve natyrore për një stil jetese të begatshme.

Pasojat negative shpesh të paparashikuara errësojnë përparimin teknologjik. Sot 23% e popullsisë konsumon më shumë se gjysmën e burimeve të energjisë dhe më shumë se 1/3 e vendeve më pjellore dhe ndoshta 25% e popullsisë në botë vuan nga uria. Rritja e popullsisë është më e shpejtë në vendet e varfra dhe më pak të zhvilluara. Nëse ata do të futen në të njëjtin standart jetese si shumica e kombeve më të zhvilluara sot, atëherë kërkesat në burimet e kufizuara të planetit dhe mbetjet do të rriten duke çuar në degradimin e mëtejshëm të mjedisit.

Çfarë mund të bëjmë për zgjidhjen e kërkesave të brezave të ardhshëm dhe në të njëjtën kohë të ruajmë cilësinë e mjedisit?

Ndoshta mësimi më i rëndësishëm është që toka është burimi ynë i vetëm. Burimet në këtë planet janë gjithçka që ne kemi. Për disa prej këtyre burimeve si: metalet, mineralet dhe lëndët djegëse fosile, ritmi i ripërtëritjes nga proceset gjeologjike është i ngadalshëm dhe janë shumë të kushtueshme që të shfrytëzohen.

Teknologjia na ndihmon të kontrollojmë shumë sëmundje, të zgjerojmë njohuritë dhe të rrisim standartin tonë të jetesës. Por nga ana tjetër teknologjitë e reja zvogëlojnë vendet e punës dhe për rrjedhojë shtrenjojnë materialet. Praktikisht, një teknologji e re duhet t'i nënshtrohet një testimi të vazhdueshëm deri në stadin e operimit të plotë.

A mundet t'i përmbahemi kërkesës për burime të reja dhe të sigurojmë burime të mjaftueshme dhe mjedis të qëndrueshëm për brezat e ardhshëm?

Ne duhet të mendojmë për kërkesën duke u nisur nga dy perspektiva: kërkesa nga e tërë popullsia e globit dhe kërkesa për frymë. Ritmet e rritjes së popullsisë janë pakësuar gjerësisht në SHBA dhe në vendet e tjera më të zhvilluara dhe ndoshta do të ndalojnë rritjen brenda 4 viteve të ardhshme (duke mënjanuar emgrimin). Ky projektim është një shenjë e mirë për të ardhmen e kombeve më të zhvilluara pasi shihet si një rast i mirë në përballimin e kërkesës për burime të reja që kanë popujt e pazhvilluar. Nga ana tjetër, konsumi për frymë në kombet më të zhvilluara është një çështje krejt tjetër. Pavarësisht kostove në rritje, çdo brez ka një nivel në rritje të bollëkut. Rritja e konsumit do të çojë në zvoglim të burimeve. Ndaj shoqëritë e sotme nuk duhet të jenë thjesht konsumatore.

Në kohën e sotme disa njerëz kanë zvogëluar vullnetarisht konsumin e energjisë duke përdorur biçikletën ose triçikletët e vegjël për transport. Kështu ata konsumojnë më pak burime, krijojnë më pak mbetje dhe zvogëlojnë dëmet mjedisore. Një grup tjetër ka zgjedhur ndryshimin tërësor të mënyrës së jetesës së tyre dhe konsumit duke lënë jetën komforte dhe të rehatshme të shtëpisë për të jetuar në rajonet më të thella të Alaskës ose vende të tjera veriore.

NJOHJA ME LËNDËN E PARË DHE MJETET E PUNËS

PIROGRAFI

Ka dy lloje kryesore pirografësh: njëri është me majë të fortë dhe laps elektrik me temperaturë të pandryshueshme, dhe tjetri është me laps djegës me majë të imët dhe një kontrollues temperature. Në ditët e sotme mund të gjeni marka të ndryshme pirografësh me kontrollues temperature. Disa prej tyre janë të ndërtuar në mënyrë të tillë që ju mund t'i bashkëngjisni vetëm dy kordonë dhe lapsa në të njëjtën kohë dhe duhet thjesht të shkëlqeni një buton për të përdorur njërin laps ose tjetrin.

Mirë është të përdorni një laps me majë të fiksuar se sa një laps me maja të zëvendësueshme. Ndoshta mund të jetë më lirë të bleni një mbajtës lapsi dhe disa maja, por do të keni një shpërndarje më të mirë të nxehtësisë me maja të fiksuara pasi edhe nuk mbinxehen shumë pas një kohe të gjatë.

Si përdoren veglat e pirografisë, kabllot dhe voltazhi

Si funksionon sistemi djegës i pirografisë dhe voltazhi?

Të gjitha njësitë moderne të djegies së drurit janë ndërtuar në të njëjtën mënyrë. Njësia ka një transformator i cili siguron fuqi dhe kontrollohet nga një pajisje e cila e kalon fuqinë në një kabëll i cili bashkohet me një laps elektrik. Qëllimi i transformatorit është të ndalojë voltazhin në një nivel të pranueshëm dhe rregullohet nga një element kontrollues që e kalon fuqinë nga kablli tek lapsi dhe maja e tij. Nga testimet e shumë prej njësive me voltazh të lartë është gjetur se që të gjitha konsumojnë 45 vat fuqi.

Pirografia

Pyetja e parë që duhet t'i bëni vetes para se të filloni është: *Çfarë lloj djegieje dëshironi të bëni?*

Nëse keni në plan të bëni shenja apo gdhendje të thjeshta atëherë qoftë edhe një djegës pa temperaturë të ndryshueshme është gjithçka keni nevojë.

Nëse dëshironi të realizoni punime artistike të tilla si peizazhe, portrete dhe piktura të tjera të cilat kanë nevojë të keni hijezime dhe djegie të imta do t'ju duhet një djegës me temperaturë të ndryshueshme.

Përpara se të filloni të merreni me pirografi duhet të merrni parasysh disa gjëra të rëndësishme:

- Pirografia nuk është një lloj i shpejtë arti. Nëse po kërkon kënaqësi të menjëhershme duhet të gjeni një hobi tjetër, si psh. vizatim ose pikturë.
- Ky lloj arti është një proces i ngadaltë dhe në rast se nxitoheni do të humbisni diçka përgjatë procesit. Duhet të tregoheni të duruar dhe të mësoni ta shijoni gjithë procesin.
- Merrni frymë thellë dhe çlirohuni. Pirografia është një art i mrekullueshëm, por ju duhet të kuptoni se për të krijuar diçka të bukur duhet t'i jepni vetes kohën e duhur për të krijuar.
- Gjithashtu, ndryshe nga vizatimi ose piktura në pirografi jeni të kushtëzuar nga nxehtësia. Majat e pirografit lëshojnë nxehtësi ndërkohë që janë duke rrëshqitur mbi dru dhe ju duhet ta ngrini për disa sekonda punton (majën) në mënyrë të tillë që ta lejoni të nxehet përsëri. Kjo është diçka normale, mos mendoni se ka diçka që nuk shkon me pirografin tuaj (fillojnë pikëzimet)
- Filloni me diçka të lehtë. Mos prisni të bleni një pirograf dhe të jeni gati të vizatoni një portret menjëherë. Punoni hap pas hapi dhe mësoni teknikat përpara se të zhyteni në diçka të komplikuar që në fillimet tuaja.

- Nëse doni të bëni vetëm shenja ose vizatime të thjeshta atëherë keni nevojë vetëm për një pirograf të thjeshtë, i cili nuk ka temperaturë të ndryshueshme.
- Nëse jeni të interesuar të bëni art, i cili kërkon vizatime të imta është e këshillueshme të investoni dhe të bleni një pirograf me temperaturë të ndryshueshme.

POR PËRPARA SE TË BLENI NJË PIROGRAF DHE TË FILLONI GDHENDJET NË DRU ME DJEGIE DUHET TË LEXONI OSE INFORMOHENI MIRE MBI MASAT E SIGURISË DHE MËNYRËN E SAKTË TË PËRDORIMIT

PAJISJE BAZË PËR DJEGIE NË DRU³

Ka tre pajisje për djegie të thjeshta në dru- njësi me një temperaturë, njësi me rezistencë për temperaturë, dhe njësi me temperaturë të ndryshme. Në këtë material do të shtjellojmë çdo stil, dhe se si çdo vegël për djegie në dru kontrollon tonalitetet e djegieve, dhe se cili stil do t’ju përshtatej më shumë.

Djegia e drurit mund të përforcoj ndjeshëm punimet tuaja me gdhendje. Ka dy lloj pajisjesh për djegie në dru- pajisja me një lloj temperature dhe pajisja me temperaturë të ndryshueshme.

Pasi të “infektoheni” nga arti i djegies në dru do të zbuloni shumë shpejt se dizajni i plotë mund të krijohet duke përdorur vetëm këtë pajisje. Djegia në dru është shumë më tepër se një përvijim në një copë druri. Me lapsin djegës ju mund të realizoni një gamë të gjerë ngjyrash dhe jo vetëm një përvijim të zbehtë me ngjyrë ari.

Pirografia krijohet nga këto elementë – njësia e djegies së drurit, majat e lapsit, modeli ose dizajni të cilin do të vizatoni me djegie në dru, dhe stili artistik që do të përdorni për realizimin e punimit.

ZGJEDHJA E PIROGRAFIT


Sikurse e përmendëm dhe më sipër ka tre lloj pirografësh - pirograf me një temperaturë, pirograf me rezistencë (reostat), dhe pirograf me temperaturë të ndryshueshme. Se çfarë lloj pirografi do të zgjidhni varet nga interesi që ju keni për këtë mjeshteri dhe nga buxheti që keni në dispozicion.

Megjithatë para se të blini pajisjet duhet të keni parasysh disa gjëra:

1. Doni të bëni djegie të tipit artistik apo artisanal
2. E keni dorën e rëndë
3. Do të bëni detaje fine apo thjesht djegie të zakonshme

Pirograf me temperaturë të pandryshueshme

Këta lloj pirografësh janë të ngashëm me pajisjet e saldimit. Majat e ngurta të zëvendësueshme janë të ndërtuara me tunxh dhe vidhosen në fund të lapsit djegës. Kur e vendosni në prizë lapsi nxehet në një temperaturë të qëndrueshme, e cila është e lartë. Majat më të forta me tunxh quhen maja universal. Kjo lloj maje tregohet në fotografinë më poshtë dhe mund të përdoret si për vijëzime delikate edhe për hijëzime.



³ <http://isirish.com/tutorials/pyrography-tutorials/fundamentals-and-techniques-pyrography/the-basic-wood-burning-tool/>

Pirograf me rezistencë



Ky lloj pirografi përdor të njëjtat maja tunxhi si pirografi me maja të zëvendësueshme me temperature të pandryshueshme. Me anë të rezistencës ju mund të kontrolloni nxehtësinë dhe të kaloni nga tonalitete të zbehta në ngjyrë kremi deri në tonalitete të çokollatës së errët.

Pirograf me temperaturë të ndryshueshme

Pirografi me temperaturë të ndryshueshme përdor një njësi me termostat në të cilin është ngjitur kordoni i lapsit. Lapsat djegës- qoftë ata me maja të fiksuara ose ata me maja të ndryshueshme – bashkëngjiten tek kordoni.

Gjëra për t'u marr në konsideratë përpara se të bleni mjetet e pirografisë

Të gjithë pirografët janë të njëjtë në thelb pasi përdorin transformator. Vetëm se disa kanë më shumë fuqi se të tjerët. Pirografët që punojnë me më shumë fuqi (3 volt) përdorin tel më të trashë të cilët marrin më shumë nxehtësi por në këtë rast humbet mundësinë për të bërë punime të imta, pasi këto të fundit mund të punohen më mirë me pirograf që kanë një fuqi prej 2 volt.

Përgatitja e drurit

Për të bërë një gdhendje të mirë me dru është e nevojshme të bëhet përgatitja e duhur e drurit. Lëmimi i drurit është shumë i rëndësishëm për të bërë një djegie të mirë të tij ose jo. Mbase të keni zgjedhur drurin që do të përdorni, përgatitja e tij për t'u gdhendur është aspekti më i rëndësishëm që duhet të merrni parasysh. Lëmojeni drurin me letër zmeril deri sa të jetë i butë mjaftueshëm për të filluar me djegien.

Kopjimi i vizatimit nga letra në dru

Në momentin që do ju duhet të kopjoni modelin do t'ju duhet të përdorni ose letër karboni ose letër kalku. Megjithatë, përdorimi i letrës së karbonit nuk është shumë i këshillueshëm pasi përmbani dyll parafine dhe gjatë djegies mund të çlirojë lëndë toksike përveç faktit që nuk të lejon të gabosh. Ndërkohë përdorimi i letrës së kalkut është një mënyrë më e mirë dhe më e sigurtë për kopjimin e modeleve në dru. Me letrën e kalkut edhe nëse gaboni është shumë e lehtë që t'i fshini këto gabime. Për më tepër



RREGULLA TË PËRGJITHSHME SIGURIE

Pjesa më e madhe e punishteve kanë rregullat e tyre të veçanta të sigurisë, të cilat zakonisht vendosen dukshëm në mure. Në mënyrë që të punoni në kushte sigurie, duke shmangur lëndimet për veten apo për ata me të cilët punoni, është e nevojshme të njihni rreziqet dhe të dini se si mund të shmangen apo të eliminohen ato. Punëtorët pa përvojë, në mjedise të reja, janë më shpesh të përfshirë në aksidente - zakonisht për shkak se rregullat e sigurisë ose nuk njihen, ose nuk ndiqen. Ndaj duhet të mësoni këto rregulla:

- Mësoni se çfarë duhet të bëni në rast zjarri apo aksidenti.
- Gjithmonë përdorni mjetet e sigurisë.
- Informoni menjëherë instruktorin në lidhje me çdo gabim që ndodh me përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve.
- Mos vraponi asnjëherë në repartet e punës.
- Mbajtja pastër dhe ajroseni vazhdimisht repartin e punës.

Një bango pune e rregullt e bën punën më të lehtë. Veglat, instrumentet matëse dhe skicat e përdorura për kryerjen e punimeve, duhet të kenë vendin e tyre mbi bangon e punës.

Një bango pune jo e rregullt sjell dëmtimin e veglave dhe të instrumenteve matëse. Kjo mund të sjellë gabime gjatë punimit ose deri në aksidente.

Nëse nuk jeni të sigurt, mos e bëni. **Kontrollojini ato para** se ti përdorni! Këshillohuni me një ekspert.

Vërejtje: Ndërkohë që shumë materiale druri dhe materiale të tjera janë konsideruar të sigurta për t'u djegur mbetet gjithnjë mundësia që ju të keni alergji nga ajo ose ndonjë reagim nga djegia e saj. Është gjithnjë e këshillueshme të merrni masa para se të filloni procesin e djegies.

- Druri i kungullit është i përshtatshëm për t'u punuar, por djegia apo gdhendia mund të shkaktojë gjithashtu edhe probleme në frymëmarrjes kështu që përdorni maska dhe punoni në një mjedis të ajrosur mirë.
- Lëkura është një tjetër material i këndshëm, por ju duhet të siguroheni që jeni duke përdorur lëkurë të lyster me vaj perimesh. Djegia në lëkurë kërkon një majë disi më të ftohtë sesa djegia në dru, por sërish ju duhet të siguroheni që të mbani një majë të pastër.
- Është këndshëm të djegësh mbi kanavaca por beni kujdes që kanavaca mbi të cilën po digjni të jetë e patrajtuar. Gjithashtu përdorni një temperaturë më të ulët dhe vendoseni kanavacën mbi një sipërfaqe të fortë dhe hekuroseni atë para se të filloni të digjni.



- Ju mund të digjni mbi çdo sipërfaqe që është e krijuar nga fibra natyrale siç është letra (për sa kohë është e patrajtuar), bambu, kanavacë, veshje nëse nuk janë të trajtuara me asgjë.

Masa të tjera të rëndësishme

- Majat për djegie janë të nxehta dhe duhet pasur kujdes për të mos u dëmtuar!
- Gjithnjë fikni djegësin pasi keni mbaruar së djeguri
- Mos i lini fëmijët për të vëzhguar afër veglave të pirografisë
- Për të shmangur aksidentet mbani zonën e punës të pastër. Bëni kujdes që të punoni në një zonë të ajrosur mirë, por jo që të ketë korente ajri mbi ju apo mbi majën e veglës sepse edhe ajo ia ul temperaturën e djegies.
- MOS digjni në materiale sintetike si akreliku, i cili përmban kimikate që janë toksike kur digjen dhe mund të shkaktojnë dëmtime serioze.
- Mos u mbështesni në informacionin e dhënë nga të tjerët pa i verifikuar ato vetë nga një ekspert i fushës. Vetëm sepse dikush e ka bërë një veprim nuk do të thotë që është e sigurtë.
- E fundit është mos digjni çdo lloj përbërjeje të prodhuar nga njeriu..... plastika, materiale të përbëra, ngjitës, akrelik, çdo gjë me origjinë të panjohur, etj. Nëse jeni të pasigurtë nëse produkti është trajtuar më parë ose nëse mbi të është aplikuar llak MOS E DIGJNI!

Sasi e kufizuar e lëndëve në vendin e punës.

Në vendin e punës duhet të mbahen vetëm ajo sasi lëngjesh dhe gazrash të djegshme, që nevojiten për ecurinë e punës së përditshme. Vendi i punës dhe dhoma e punës duhet të pastrohen e ajrosen rregullisht.

Situata rreziku

- a. Alergjitetë nga druri, reaksione & toksifikim. Përdorimi i panjës mund të shkaktojë reaksione në rrugët e frymëmarrjes.
- b. *Kujdes nga tymi që mund t'ju hyjë në sy.* Ky është një problem që haset shpesh dhe për të evituar problemet mund të merren disa masa. Mund të mbani një ventilator/ freskore për të larguar tymin nga sytë. Ju duhet të punoni në një mjedis larg banorëve të tjerë të shtëpisë, të veçuar dhe të ajrosur mirë. Nëse ju jeni duke djegur në dru me vajra, katran ju duhet të bëni shumë kujdes për të mbrojtur të tjerët në familje. Nëse ju mund të jeni duke djegur në një dhomë të veçantë, mbyllni derën dhe ajroseni dhomën nga një derë apo dritare tjetër. Por edhe me gjithë këto masa sigurie që mund të merrni i gjithë tymi nuk del nga dhoma. Është vënë re se edhe duke e bërë këtë dhe duke pritur disa ditë ka pasur ende tym toksik në ajër kështu që nuk rekomandohet djegja në drurë të tillë.

Pajisje personale sigurie

Mbrojtja e syve: Gjatë punës me makina a pajisje të ndryshme, në rastet kur rrezikojnë të na bien cifla në sy, duhet të mbahen syze me strehë anësore mbrojtëse.

Mbrojtja e lëkurës: Për duart të përdoren dorashka.

Mbrojtja e trupit: Të mos mbahen veshje që ngarkohen lehtë elektrikisht (jo veshje sintetike, por me përqindje të madhe pambuku!)

Mbrojtja e këmbës: Të mbahen këpucë.

Ndihma e shpejtë

Tek çdo ndërhyrje për ndihmë të shpejtë: Të mbahet parasysh vetëmbrojtja, trajtimi mjekësor, masat e menjëhershme të shpëtimit të jetës si “vendosja në pozicion stabël”, “rigjallërimi i zemrës dhe mushkërive”, “luftimi i tronditjes”, të cilat duhet të zbatohen në varësi të situatës. Plagët të mbuloohen në mënyrë sterile. Të kujdesemi për qetësinë/rehatinë e trupit dhe të mbrojmë nga humbja e nxehtësisë.

Pas kontaktit me sytë: Të shpëlahen menjëherë kapakët e hapur të syve me ujë të bollshëm (për rreth 10 min).

Pas kontaktit me lëkurën: Rrobat e papastra, të brendshmet dhe këpucët, të hiqen menjëherë. Të shpëlahet lëkura me shumë ujë.

Pas frymëmarrjes: I dëmtuari të hiqet nga zona e rrezikut. Marrje e ajrit të pastër nëpërmjet frymëmarrjes ose thithjes së ajrit të pastër. Të përdoren ndihma për frymëmarrjen (vetëmbrojtje).

Pas gëlltitjes së lëndëve të rrezikshme: Shpëlarje e menjëherëshme e gojës. Uji të pihet në gllënjka të vogla.

KONTROLLI DHE MIRËMBAJTJA E PAJISJEVE DHE VENDIT TË PUNËS – KËSHILLA

Kujdes: Disa materiale nuk janë të sigurta gjatë djegies.

- MOS digjni në dru të presuar. Ai është i trajtuar me kimikate që, edhe pse nuk janë të dëmshme kur druri përdoret për arsye ndërtimi, në thelb janë të dëmshme për drupunesit apo pirografët.
- MOS digjni në material MDF. MDF është e mbushur me kimikate dhe formaldeidë që janë të pasigurta dhe nuk duhet të përdoret për pirografi.
- MOS përdorni asnjë lloj druri të trajtuar: kimikisht, me njolla, të lyera, të llakosura, etj. Nëse duhet patjetër të përdorni këto lloj druri sigurohuni që ta keni zmeriluar mire dhe t'i keni hequr të gjitha mbetjet dhe të filloni të digjni në dru të pastruar.
- MOS digjni në asnjë lloj materiali plastik. Gjeni metoda më të sigurta për të transferuar modelin dhe objekte më të sigurta për të djegur. Plastika nuk është shpikur për t'u djegur nga njerëzit, ndaj jini të kujdesshëm.
- NUK është e sigurt djegia në materiale si: ngjitës (ngjitës dhe maskues), bojra për lyerje apo kopjative; letër e cila është e përdorur dhe në shumë gjëra të tjera.
- Mbani parasysh që disa tymra toksik të çliruara gjatë djegies në disa prej këtyre materialeve mbeten ende në ajër për një kohë të gjatë edhe pasi keni mbaruar së djeguri. Kështu që për sigurinë tuaj dhe të tjerëve që mund të hynë në këto mjedise duhet të tregoheni shumë të matur.
- Bëni kujdes që duart t'i keni të pastra para se të filloni punën. Ju muind te vendosni një letër poshtë dorës suaj në mënyrë që të mos penetrojë vaji/ yndyra në dru.
- Nëse punoni më dorën e djathtë filloni punën nga e djathta në të majtë, nëse jeni mëngjërash filloni nga e majta në të djathtë në mënyrë që të mos fshini vijat e modelit.

KAPITULLI 2 TEKNIKAT E VIZATIMIT DHE REALIZIMI I NJË MOTIVI TË THJESHTË

Edukim figurativ⁴

SHPJEGIMI I VIZATIMIT

Objektivat:

1. Të dallojë teknikat kryesore të artit dhe veçoritë e tyre
2. Të dijë të përzgjedh bazën materiale për procesin e punës
3. Të jetë i aftë në përdorimin e mjeteve që i nevojiten

VIZATIMI ME LAPS (LETRA, GOMA)

Lapsi është një mjet mjaft i hershëm që përdoret për shumë procese, gjithashtu për të vizatuar. Përdorimi i lapsit në vizatime nuk shihet thjesht si një mjet mekanik, por një mjet i fuqishëm shprehës me të cilin janë krijuar veprat e artit.

VETITË E LAPSIT:

- Është i thjeshtë në përdorim.
- Jep mundësi për korrigjim gjatë punës.
- Përdoret në disa lloje letrash.
- Gjatë përdorimit krijon efekte tonale, lëvizje nëpërmjet linjave, kontraste grafike, etj.

Tonaliteti i lapsit ka të bëjë me mënyrën e përdorimit, llojin e tij dhe konceptit të veprës së autorit. Duke qenë se është i thjeshtë dhe i lirshëm në përdorim, me të nëpërmjet vijave (linjave) krijojmë variante nga më të ndryshme teksturash dhe sfumaturash me gisht apo gomë.

LETRA

Letrat e vizatimit janë të formateve të ndryshme dhe të cilësive të ndryshme. Por, kur ne vizatojmë duhet të zgjedhim një letër jo me llustër, por poroze (të ashpër) që pastrohet lehtë nga goma dhe që mban gjurmët e lapsit, përjashtoj rastin kur ne punojmë me penë. Dimensionet (përmasat) zgjidhen sipas veprës që kemi ndërmend të realizojmë.

GOMA

Edhe goma është mjet pune në shërbim të lapsit (vizatimit) që përdoret për të pastruar, për sfumatura, por nëpërmjet saj ne krijojmë edhe efekte kontrastuese.

Goma është bashkëudhëtare e punës në vizatim sepse duke pastruar ajo thith çdo gjurmë të lapsit që nuk na nevojitet.

Ushtrim: Vizatoni në fletoren e vizatimit një sferë, një kub, një cilindër dhe trajtojini ato me dritë hije.

⁴ Hasani, A. (2009): "Edukim figurativ 6", Uegen

STAMPIMI (PIROGRAFI, GUR, DRU)

Ekziston si një mënyrë e vjetër përdorimi nga njerëzit për të krijuar variacione të ndryshme të dekorimit në përgjithësi. Është një nga variantet e modeleve të tekstileve të kompozuara nga piktorët. Stampimi lehtëson mundësinë e gjetjes së shumë formave të dëshiruara, por të stilizuara për t'i dhënë gjithmonë vlerën e artit.

Modelet mund të bëhen me karton, me materiale të gomuara duke i prerë dhe duke i dhënë forma të ndryshme sipas zgjedhjes së artistit për atë që dëshiron të bëjë dhe të stampojë në karton, dru, gur, etj.

Si veprohet:

Mbasi e kemi vizatuar formën që dëshirojmë e presim sipas linjës me kujdes. E vendosim kartonin mbi materialin që do të stampojmë dhe e sprucojmë me ngjyrë nga lart ose me sfungjer të lyer me bojë ose nëpërmjet lapsit. Shpërndarjen e dekorimit e bëjmë sipas idesë që kemi projektuar.

Krijimi i stampave me gdhendje

Para se të krijojmë stampa me gdhendje në rradhë të parë duhet të kemi zgjedhur motivin që do të gdhendim. Zgjedhja e motivit duhet të jetë e përshtatshme për teknikën e gdhendjes në dru ose gur.

Ushtrime:

Prisni në karton një model stampe edhe tentoni të provoni gdhendjen në dru ose në gur.

LINJAT (GUR, DRU, PIROGRAFI, BAKËR)

Objektivat:

- Të njohë dhe të vlerësojë elementet dhe parimet e artit vizual si pjesë e rëndësishme e veprës.
- Të vëzhgojë, të interpretojë dhe të analizojë elementet dhe parimet e artit në çdo lloj imazhi viziv.

VIJAT (LINJAT)

Vija (linja) në kuptimin matematikor është një drejtëz lakore, planore, dhe hapësinore. Në hapësinë ajo vërtetë nuk shfaqet, por perceptohet me syrin e mendimit imagjinar dhe që merr emrin vijë (linjë). Vija në artet vizive është një përmasore. Por duke u përfshirë në një hapësinë më të gjerë ajo merr vlera dhe tri përmasore, sipas funksionit që kryen dhe vendit që zë në një vepër arti.

Pra, kur flasim për vijën në një vepër arti, duhet të njohim llojet e tyre dhe efektet emocionale që krijojnë ato. Kemi disa lloj vijash:

- të trasha (konture)
- të holla
- horizontale
- vertikale
- të pjerrëta

- të harkuara, të lakuara
- rrethore
- zik-zake
- të shkëputura detyruese, etj.

Në artet vizuale, vija paraqet një shëmbëllim grafik. Por, ç'tregojnë ato si vlera emocionale?

Horizontalja – tregon qetësi dhe siguri absolute

Vertikalja – tregon fillimin e një tensioni

Detyruesja – tregon jo stabilitetin sepse ndodhet midis horizontales dhe vertikales

Rrethorja, të thyerat, me kthesa – tregojnë se përmbajnë një forcë dinamike dhe sugjerojnë idenë e një sipërfaqeje.

Ushtrim

Realizoni një temë të lirë ku të theksohen linjat (vijat) nëpërmjet lapsit.

FORMAT

Formimi i konceptit mbi format në përgjithësi ka të bëjë me aftësinë për të fiksuar dallueshmërinë e formave natyrore. Konceptet mbi format natyrale rrjedhin intuitivisht në jetën e përditshme. Duke shfrytëzuar pafundshmërinë e tyre ato i ndajmë në forma gjeometrike, forma organike, forma manuale (të krijuara nga vetë njeriu).

Në format gjeometrike kemi të bëjmë me trekëndorë, rrethorë, katërkëndorë, etj. të cilat kanë dhe rregulla në strukturën e ndërtimit dhe zërthimit të tyre.

Ndërsa format natyrore organike janë në variacione të pafundme. Format i ndajmë në dypërmasore dhe tripërmasore në kuptimin e përmasave (gjerësi, lartësi dhe thellësi), që ato plotësojnë. Kur njëformë plotëson dy nga këto përmasa në artet vizive quhet **dypërmasore**. Ndërsa kur i plotëson të tre përmasat quhet **tripërmasore**.

Format dypërmasore

Këto forma i kemi gjeometrike dhe manuale (të krijuara nga dora). Të gjitha format që ne vizatojmë, qofshin këto gjeometrike apo natyrale, pra piktura, grafika, vizatimi etj. quhen dy dimensionale (dypërmasore). Në momentin që funksionon dritëhija në art ato krijojnë iluzionin e tripërmasores.

Format tripërmasore

Format tripërmasore quhen të gjitha format organike (hapësinore) që lidhen ngushtë me vëllimin. Ndërsa në vepra arti tripërmasore futet skulptura. Kjo vepër quhet tripërmasore sepse plotëson tri përmasat: lartësi, gjerësi, thellësi.

Artistët në përgjithësi duke shfrytëzuar këto pafundësi formash kanë krijuar çudira me artin e tyre, sepse aftësia për të qenë krijues në shfrytëzimin e formave të pafundme ka të bëjë me dhënien e situatave të pazakonta në art.

Ushtrim

Pirografi -Vizatoni në fletoren e punës një vizatim (një figurë gjeometrike) me dritëhije për të kuptuar iluzionin e formës.

Dru-gur, bakër - Punoni detyrë shtëpie me plastelinë mbi një copë kompensatë një figurë sipas dëshirës për të kuptuar formën tripërmasore.

VLERA (DRITËHIJE)

Kur flasim për dritëhijen në pikturë, vizatim, grafikë, karbon etj., duhet të kuptojmë vlerën tonale të saj, si funksionon ajo brenda veprës dhe çfarë efektsh emocionale na krijon. Pra, për të kuptuar dritëhijen në përgjithësi duhet të njohim shkallën tonale të ngjyrave shumëngjyrëshe, por kjo shkallë mund të jetë dhe njëngjyrëshe (akromatike), që krijohet nga e bardha tek e zeza dhe e kundërta.

Artisti që e njeh këtë parim tonal e përdor atë me mjeshtëri në vepër dhe krijon iluzionin vëllimor të objekteve, çka i jep vlerë vizatimit.

Objekti që vizatohet ka dy lloje hijesh: hijen që e krijon vetë objekti në pjesën që nuk ndriçohet dhe hija që lëshon ai në objektin e vendosur. Trajtimi i këtyre të dyjave i japin vlerë një vepër arti.

Ushtrim:

Vizatoni në fletore një sferë me dritëhije.

SIPËRFAQJA (BAKËR, PIROGRAFI, GUR, DRU)

Mundësia e të qenit së bashku e një objekti (e çdo lloji qoftë) nënkupton noncionin e strukturës. Kjo strukturë ka edhe një unitet në tërësinë e saj. Duke qenë se një objekt i çfarëdo përmase qoftë ka një strukturë lidhëse, ka njëkohësisht dhe një sipërfaqe.

Sipërfaqja është e dallueshme nga pamja e përgjithshme, por duke ndërhyrë në brendësi ajo ka lidhjet e veta të ndërtimit qoftë të rregullta apo ritmike, simetrike dhe asimetrike.

Duke u nisur nga këto informacione konstatojmë se kemi disa lloj sipërfaqesh:

- të lëmuara
- të ashpra
- të përziera
- të rregullta
- të çrregullta

- natyrale
- artificiale, etj.

Ushtrim:

Bëni në shtëpi një vizatim të çfarëdoshëm me laps ku të trajtoni sipërfaqen e objektit.

HAPËSIRA

Duke u nisur nga elementet dhe parimet e artit figurativ një nga të rëndësishmet është hapësira. Ajo ka një koncept të gjerë, të drejtpërdrejtë dhe nga ana figurative e pozicioneve të objekteve të hedhura në kuadër, sipas planeve dhe rëndësisë së tyre në kompozim dhe ngjyrë, sipas konceptit të qartë të autorit në punën e tij.

Konfiguracioni i natyrës dhe cilësia e dritës shërbejnë si shtytës për artistët për një përcaktim pamor të hapësirës, ku boshllëku dhe masa gjejnë vazhdimësi.

Artisti brenda shkruan në mënyrë reduktive një sasi fizike të hapësirës që e lidhin me perceptimin psikondjesor të shikuesit. Preçizioni i hapësirës është i mundur edhe pse shohim dhe regjistrojmë një imazh tjetër. Ky është një efekt që lidhet me emrin perspektivë, pasi syri ynë verifikon objekte në distancë.

Ushtrim:

Bëni një vizatim në fletoren e punës me temë “Rrugë me pemë” për të kuptuar hapësirën.

THEKSI

Gjatë momentit që ne kompozojmë ndjekim disa rregulla jo strikte, por të domosdoshme dhe midis të tjerave në përfundim të veprës duhet të bjerë në sy theksi. Pra, theksi është ai fragment ose pjesë e veprës më e identifikuar që bie menjëherë në sy të shikuesit, që në kontaktin e parë të tij.

Në pikturë theksi identifikohet ose mund të shprehet me

- ngjyrën e theksuar (kontrast)
- lëvizjen interesante
- linjën e theksuar (konturi) etj.

Në skulpturë theksi dallohet:

- nga lëvizja interesante
- pesha, masa, vëllimi, etj.

Të gjitha këto domosdoshmërisht në marrëdhënie me hapësirën që e rrethon, ku dritat natyrale dhe artificiale gjejnë një vazhdimësi të tyre.

Ushtrim:

Bëni një vizatim duke përdorur lapsin dhe vini në dukje theksin duke e shpjeguar me fjalë.

PIROGRAFI – AKUARELI, TEMPERA

Është një nga variantet e pikturës me bojëra uji. Këto bojëra gjatë përdorimit në pikturë treten në ujë dhe punohen me penela të posaçëm për t'u përzier (penela akuareli).

Piktura me akuarel është aq sa interesante, po edhe delikate gjatë procesit të punës. Akuareli është përdorur në të gjitha rrymat e artit të pikturës.

Si veprohet konkretisht:

Zakonisht pikturat në akuarel bëhen në letër poroze, e cila mban ujë gjatë përdorimit në një masë të caktuar. Futet peneli në ujë dhe përzihen ngjyrat që duam me njëra-tjetrën. Mbase jemi bindur për njollën që do të na duhet, e hedhim në sipërfaqen e letrës ose drurit sipas radhës së punës.

Në hedhjen e ngjyrës në letër ose dru duhet të jemi shumë të saktë për arsye se kjo lloj pikturë nuk pranon shumë ndërhyrje.

Tonalitetin ngjyror e respektojmë nëpërmjet penelit nëse e ngarkojmë me ujë apo e hedhim gjysëm të thatë. Në rast se na duhet për të mbuluar ngjyrën, do të bëjmë shumë kujdes që të nisemi nga e zbehta tek e errëta, për ta çuar detyrën drejt studimit dhe përfundimit të saj. Akuareli nuk pranon mbivendosje.

TEMPERA

Është një nga teknikat më të përhapura të punimit të bojërave me origjinë mesjetare. Ka origjinë përdorimi më të hershme se akuareli. E përbashkëta me akuarelin është se ato treten në ujë. Me tempera mund të punojmë në karton, telajo, letër, kompensatë, dru, etj.

VETITË E TEMPERAVE:

- Është praktike gjatë procesit të punës.
- Nuk krijon shkëlqim pasi është mat.
- Ka veti mbuluese, duke na dhënë mundësi për korrigjimin e gabimeve të mundshme gjatë pikturimit.
- Në familjen e temperave hyjnë akuareli, guashi dhe akriliku.

Ushtrim :

Realizoni një temë të lirë me akuarel ose temper sipas preferencave tuaja.

PËRDORIMI I FOTOGRAFIVE SI MODELE PËR TË DJEGUR NË DRU⁵

Modele vs. Fotografi

Me një model nuk mund të jesh kurrë i/e sigurtë nëse është i saktë pasi shumicën e rasteve nuk janë. Shpesh ndodh që pasi hidhet modeli në dru dhe fillohet djegja të ketë disa pasaktësi. Disa nga problemet kryesore që hasen kanë të bëjnë me përdorimin e gabuar të dritës dhe hijeve apo se modelet nuk do të mund t'ju japim imtësitë që janë të nevojshme për krijimin e një djegieje sa më reale.

Krijimi i punimeve natyrale dhe sa më të gjalla, dhe jo fotokopje mund ta arrihet duke përdorur modele. Modelet janë mirë të përdoren në fillim, kur akoma nuk është krijuar vetëbesimi i duhur për të punuar vetëm duke u bazuar në një fotografi. Por, në momentin që jemi më të sigurtë duhet të provohet vizatimi me djegie duke u bazuar tek fotografitë.

Krijimi i modeleve duke u bazuar tek fotografitë

Mund të krijohen modele lehtësisht nëse janë veglat e duhura, dhe kjo është e vetmja mënyrë që të realizohen krijime sa më realiste. Ju nuk do të mund të ngërtheni thelbin e një dizenjoje duke përdorur një model, pavarësisht se sa i mirë mund të jetë modeli. Ju do të mund të nxirrni në pah hollësi, hijezime të duhura duke punuar me fotografi.

Nëse do të përdoret një foto, gjëja e parë që duhet bërë është gjetja e një fotoje të qartë me kontrast të mirë. Ju mund të zmadhoni ose zvogëloni foton sipas madhësisë që dëshironi. Nëse fotografia është me ngjyra ju mund ta konvertoni atë në foto bardh e zi që të mund të dalloni më mirë hijezimet, dhe të bëni rregullimet që ju nevojiten për ta bërë foton sa më të qartë.

Mënyra më e mirë për të punuar me një fotografi është të përdoret skaneri. Nëse keni një skaner dhe softwer për fotografi ju mund t'i skanoni fotografitë dhe t'i konvertoni ato nga foto me ngjyra në foto bardh e zi, dhe të bëni rregullimet e duhura për siguruar qartësinë, kontrastin dhe ndriçimin, etj. Nëse nuk keni një skaner ose softwer fotografish mund të bëhet kopje e fotografisë në një makinë fotokopjuese dhe të rregullohet aty kontrasti dhe ndriçimi deri në nivelin që duhet për të siguruar qartësi. Bëni dy kopje të fotografisë, një mund ta përdorni për të nxjerr gjurmën në dru dhe tjetrën mund ta përdorni si referencë.

Përdorimi i fotografive të dikujt tjetër dhe e drejta e autorit

Duhet theksuar se edhe fotografitë mbrohen nga e drejta e autorit, ndaj nëse keni ndërmend të përdorni fotografi të dikuj tjetër dhe jo tuajat kërkoni autorizimin e këtij të fundit.

Ju mund të përdorni material të mbrojtur me të drejtë autori dhe fotografi të të tjerëve si referencë dhe punimin mund ta mbani për veten tuaj. Kjo do të thotë se nëse bëni djegie në dru një kokë dreri është në rregull të kërkoni në internet dhe të gjeni fotografi me dre. Por nuk është mirë që të bëni një kopje ekzakte të fotografisë, ta digjni saktësisht siç është dhe më pas ta shisni punimin si vepër origjinale. Sigurisht, që ka edhe fotografi të hedhura në internet që janë për përdorim publik, por gjithmonë duhet të siguroheni nëse nevojitet të kërkoni leje nga autori i fotografisë apo jo.

⁵ <http://www.sawdustconnection.com/Pyrography-Woodburning-Tools-Reviews-Comparisons.htm>

KAPITULLI 3. TEKNIKAT E PRODHIMIT

Përgatitja e drurit

Përgatitja e duhur e drurit është thelbësore për një djegie të mirë të drurit. Nëse nuk merrni kohën e duhur për të zmeriluar drurin siç duhet, ajo mund të bëjë diferencën ndërmjet një djegieje të dobët dhe asaj të shkëlqyer. Pas përzgjedhjes së drurit për projektin tuaj përgatitja për djegien është pjesë më e rëndësishme e projektit. Bëni kujdes që ta keni pastruar plotësisht drurin para se të filloni punën. Druri duhet të jetë lëmuar si lëkura e një bebeje kur të keni mbaruar punë.

Transferimi i modelit në dru

Transferimi me letër grafiti – është mënyra më e mirë dhe më e sigurt për të vënë modelin në dru. Grafiti është më i lehtë të hiqet nëse bëhen gabime, mund të mbeten vetëm shenja të cilat mund të hiqen gjatë djegies. Është e sigurt dhe jo toksike.

Letër pirografie, është një nga risitë që po përdoret në fushën e pirografisë. Ju mund të printoni mbi këtë letër dhe të kryeni procesin e djegies mbi të, por kujdes se djegia e bojës së printerit mund të rezultojë toksike. Letrat mund të përmbajnë ngjyruet ose pigmente.

Adeziv – është një tjetër ndihmë për transferimin e modelit në dru. Mund të punohet edhe mbi maskën e ngjitur në dru, por djegia e materialit ngjites mund të lëshojë lëndë të rrezikshme.

Si të transferojmë modelin në dru?

Pocesi i aplikimit të modelit dhe i grafitit në dru duhet të jetë shumë preciz. Vendosja e saktë e letrës së grafitit është thelbësore. Nëse e vendosni në anën e gabuar ju do të transferoni krijimin në pjesën e mbrapme të modelit në vend që ta bëni në dru. Ndaj fillimisht vendosni grafitin me pjesën e bardhë lart dhe skiconi një vijë për të testuar dhe siguruar që po punoni në drejtimin e duhur. Duhet ta fiksoni mirë letrën në mënyrë që të mos lëvizë. Përdorni ngjitës për ta fiksuar, mundësisht ngjitës prej letre në mënyrë që të hiqet lehtë dhe pa lënë shenja të adezivit në dru. MOS E NGRINI modelin për të kontrolluar punën, sepse ka shumë mundësi që modeli të mos shkojë sërish në të njëjtin vend dhe vijat nuk do të korespondojnë. Kur të shkruani mbi modelin për ta transferuar atë në dru keni kujdes që të mos shkruani shumë fort apo shumë lehtë, sepse në rastin e parë mund të mbesin shenja edhe pas djegies dhe në rastin e dytë mund të mos jetë kaluar një pjesë e mirë e vijave nga modeli në dru. Mund të provoni forcën e shtypjes në një qoshe.

Pasi ta keni kaluar modelin në dru (apo në ndonjë model tjetër) sigurohuni që të keni nxjerr gjithë vijat, duke mbajtur gishtat fort në mënyrë që letra të mos lëvizë. Nëse humbisni disa vija mund ti skiconi me laps më vonë. Mbasi të mbaroni gjithë vijat atëherë jeni gati për të filluar punë me djegien.

Këshilla:

Bëni kujdes që duart t'i keni të pastra para se të filloni punën. Ju mund të vendosni një letër poshtë dorës suaj në mënyrë që të mos penetrojë vaji/ yndyra në dru. Nëse punoni më dorën e djathtë filloni punën nga e djathta në të majtë, nëse jeni mëngjërash filloni nga e majta në të djathtë në mënyrë që të mos fshini vijat e modelit.

Mbani gjithnjë pranë jush një tabelë prove dhe përdoreni para se të filloni procesin e djegies në mënyrë që të provoni temperaturën e djegësit apo për të eksperimentuar me teknikën.

Kini parasysh që duke punuar mbi sipërfaqen e drurit, temperatura e majës bie. Mund ta kuptoni nga ngjyra, në fillim djegia fillon me ngjyrë të errët dhe më pas bëhet më e hapur ndërkohë që humb nxehtësi. Duhet ta hiqni paksa majën nga druri (koha varet nga tipi i majës) në mënyrë që ti lini kohë asaj për t'u nxehur sërish. Nëse jeni duke përdorur një majë të hollë do t'ju duhet vetëm disa sekonda. Kjo është normale dhe nuk ka asnjë problem me djegësin tuaj.

Mos e ngrini temperaturën më lart seç duhet. Është më mirë të digjni me shtresa sesa ta bëni të gjithë punën shpejt, me një kalim. Djegia në temperaturë më të ulët do të ruaj gjithashtu edhe jetën e majave, veçanërisht kur jeni duke punuar me një majë për detajimet, maja nuk duhet të përdoret si mashë e nxehtë apo të jetë e kuqe.

Si të kontrollohen tonet e errëta dhe të lehta?

Ka disa mënyra:

- Rrisni temperaturën (nuk është shumë e rekomanduar)
- Ulni temperaturën
- Lëvizni dorën më shpejt për një djegie më të lehtë
- Lëvizni dorën me ngadalë për një djegie më të fortë.
- Digjni me shtresa (e rekomandueshme)
- Përdorimi i një copë lëkure dhe i oksidit të aluminit
- Kur punoni me djegie do ju duhet që të pastroni shpesh edhe majat. Beni kujdes që majat të jenë të ftohura.



Udhëzime mbi përdorimin e rripave të lëkurës apo të oksidit të aluminit: hidhni vetëm pak oksid alumini në njërin skaj të lëkurës, dhe kaloni majën rrotull pudrës vetëm disa herë, dhe më pas në një anë të pastër të lëkurës fërkoni majën dhe e pastroni butësisht atë. Ju duhet ta bëni këtë gje vetëm pak herë. Qëllimi është të pastrohet maja dhe jo që hiqni ngjyrën që merr maja nga nxehtësia.

Kujdes nga tymi që mund t'ju hy ne sy

Ky është një problem që haset shpesh dhe për të evituar problemet mund të merren disa masa. Mund të mbani një ventilator/ freskore për të larguar tymin nga sytë.

Ju duhet të punoni në një mjedis larg banorëve të tjerë të shtëpisë, të veçuar dhe të ajrosur mirë. Nëse ju jeni djegur në dru me vajra, katran ju duhet të bëni shumë kujdes për të mbrojtur të tjerët në familje. Nëse ju mund të jeni duke djegur në një dhomë të veçantë, mbyllni derën dhe ajroseni dhomën nga një derë apo dritare tjetër. Por edhe me gjithë këto masa sigurië që mund të merrni i gjithë tymi nuk del nga dhoma. Është vënë re se edhe duke e bërë këtë dhe duke pritur disa ditë ka pasur ende tym toksik në ajër kështu që nuk rekomandohet djegja në drurë të tillë.

Punoni me shtresa

Është gjithashtu shumë e rëndësishme djegja në shtresa, shtresat e poshtme të parat – tamam siç veproni me veshjen tuaj. Kjo do t'i japë punës tuaj thellësi dhe e bën të duket më e gjallë/ natyrale.

Trëndafili i treguar më poshtë është bërë nga një fotografi dhe është një shembull shumë i mirë i shtresëzimit. Nëse e studioni atë nga afër ju do të filloni të kuptoni konceptin dhe të ndjeheni më rehat kur të filloni projektin tuaj.



Shkurtimi

Kur të keni zotëruar shtresëzimin ju keni nevojë të krijoni thellësi. Një teknikë që ju ndihmon për të bërë djegjen e drurit që shkon nga një djegje e sheshtë deri në pjesë që duket sikur druri del jashtë dhe duket sikur është gdhendur teknika e shkurtimit. Duke përdorur anën e hijes ose thikë të rrumbullakët gdhendëse prapa shtresës së lartë në një mënyrë "duke ngritur dhe veçuar" atë nga shtresa e mëposhtme. Ajo sjell shtresën e lartë përpara dhe shtyn shtresën e poshtme mbrapa. Nëse ju shikoni një send mbi një tavolinë, do vini re hijen e krijuar nën të. Kjo hije është ajo që ju krijoni mes dy shtresave. Kjo ndihmon në krijimin e një djegjeje që të duket sa më natyrale.

Sytë

Sytë janë "dritaret e shpirtit" dhe pjesa më e rëndësishme e çdo fytyre që krijoni, djegni dhe pikturoni. Nëse sytë nuk duken mirë atëhere duhet ta hidhni pjesën e punuar dhe të filloni nga e para. E thënë ndryshe kur punoni për bërjen e një fytyre filloni nga sytë. Nëse ato do bëhen si duhet pjesa tjetër është më e lehtë. Kur krijoni sytë duhet të përdorni shtresëzimin

"Fshirësi magjik"

A mund të fshihet një gabim? Pak a shumë! Mund të përdoret fshirësi magjik, kjo është një vegël e veçantë e quajtur –brisk me një teh. Për sa kohë nuk keni bërë djegie shumë të errëta dhe të thella, ju mund të përdorni tehun e briskut. Bëni kujdes që ta bëni shumë butësisht, në mënyrë që të mos prisni drurin. Bëni kujdes që pasi të keni mbaruar të pastroni të gjithë pluhurin para se të filloni të digjni sërish.

Të dish kur të ndalosh

Një tjetër problem i zakonshëm me artizanët është të dinë se kur duhet të ndalojnë dhe të thonë që punimi ka mbaruar. Nëse shikoni punimin tuaj dhe gjeni se diçka nuk shkon por nuk jeni i sigurt se çfarë, provoni ta mbani atë përpara një pasqyre dhe shikojeni atë në pasqyrë. Kur të mendoni se keni mbaruar me djegiet, vendoseni objektin mënjane për disa ditë dhe mos e shikoni. Më pas vendoseni atë si në një vitrinë, qëndroni pas dhe thjesht hidhni një sy herë pas here. Ky është momenti kur ju do të gjeni gjëra që mund të kenë nevojë për t'u rregulluar, ndryshuar etj. Por gjëja më e rëndësishme është që të mos e ripunoni.

Finalizimi i punës suaj.

Pasi të keni mbaruar punë me djegiet do të ishte mire që të fërkonit objektin prej druri me një letër. Bëni kujdes të përdorni pjesën e brendëshme të letrës ku nuk ka asnjë printim, përndryshe do të përfundoni me njolla boje në punimin tuaj. Kjo është një mënyrë shumë e mirë për të hequr djegiet e tepërta të karbonit nga druri.

Firmosja e punës suaj.

Jini krenar për punën tuaj dhe bëjini të ditur të tjerëve se kush jeni. Ndoshta një ditë do të bëheni i famshëm. Firma juaj është e rëndësishme sepse tregon se kush e ka bërë punën. Zakonisht si firmë përdoret emri dhe viti (p.sh: xxxx '14) dhe në nën e pasme mund të vendoset emri i plotë bashkë me vitin (p.sh: xxx 2014) dhe titullin e punimit.

Dhënia e dorës së fundit.

Pasi të jeni kënaqur me djegien e punimit tuaj, është koha për ti dhënë dorën e fundit. Përdorni një llustër satin ose mat në dorën e fundit për të mos pasur një shkëlqim që heq vëmendjen nga punimi artistike. Disa përdorin llakun në fund dhe përdorin llustër të shpejtë me rezultate të mira, por duhet të tregoni shumë kujdes gjatë përdorimit të saj dhe sidomos duhet përdorur në vende mjaft të ajrosura, mundësisht jo në ambientet e shtëpisë. Mund t'i kaloni me llak poliakrelik me një furçë në dorën e fundit, e cila nuk ju jep efektin e tymosjes (pamjen e turbullt) dhe ju jep një pamje më profesionale që është e lëmuar dhe pa vijëzime. Është me bazë uji dhe pastrohet lehtësisht me ujë e me sapun. Ky llak do ti bëjë më të theksuara djegiet dhe më të dukshme pa e ndryshuar pamjen e punimit. Mos përdorni llakun të ndritshëm gjatë llakosjes sepse do të tërheq vëmendjen nga punimi dhe do të krijoj reflektim.

Përdorimi i ngjyrave në pirografi – Djegia e drurit me ngjyra

Mund të përdoren bojra ose penjë arkrelike, apo me bazë argjile ose vaji në varësi të efektit që duam të japim. Në fotografi mund të shihni një shembull të djegies të bërë me bojra vajore (pa hollues boje) e përzier me një shkop përzierës dhe e përdorur thjesht si një theksues vetëm në zonat me shirita dhe rripa në vjeshjen e kokës.



Në foto mund të shihni një punim pirografie të një fari, sërish pa përdorur asnjë hollues bojrash, me bojrat e vajit por duke e përzier me një shkop përzierës. Është realizuar pa përdorur ngjyra as në sfond, shkëmbinj, rërë dhe në disa pjesë të farit. Ngjyrat janë shtuar vetëm në zonat ku nuk kishte djegie. Nuk është aplikuar llak në punim para se të përdoreshin ngjyrat, megjithatë ka edhe nga ata që i kalojnë një llak të lehtë para se të shtojne ngjyrat.



Mundësitë për të shtuar ngjyra.

Lapsa: vajore, bojra uji, me bazë argjile (hije më të lehta se ajo vajore dhe përzihet më lehtë), të gjitha bojrat pastel mund të përzihen lehtësisht, disa më lehtësisht se të tjerat. Përzierja mund të bëhet me gishta, pëlhura, shkop përziers në varësi të efektit që duam ti japim. Ju mund të përdorni një hollues kur përdorni bojra vaji. Bojra akrelike ose bojra me bazë uji: të disponueshme në një varietet ngjyrash. Lejon dukshmërinë e strukturës së drurit. Ngjyrat janë më vibrante se me lapsat. Bojrat: vajore, akrelike, me bazë ujore të gjitha janë pak të çrregullta por mund të përdoren në shumicën e sipërfaqeve.



Krijimi i një punimi artistik si element atraktiv i zonës:

Mjetet punës: Sharrë, Tryela, Lymë gjysë rreth , Lymë rrethore dhe mjeti djegës

Marrim një sipërfaqe dërrase me përmasa katrore 25x25 cm. E krijojmë konceptin në një fletë format pastaj vazhdojmë me vizatimin në dru. Presim sipërfaqet e skicuara me sharrë, krijojmë ajrin mes punimit me Tryelë dhe Sharrë (në këtë rast I LOVE MIRDITA), krijojmë bazamentin ku do vendoset punimi pastaj me mjet djegës bëjmë pikturimin MIRDITA





Funded by
the European Union



Moduli punim me dru

KAPITULLI 1 Njohja dhe përdorimi i mjeteve të punës dhe lënda e parë

1. Njohuri kulturore mbi artizanatin tradicional
2. Historiku i zanatit të gdhendjes në dru
3. Llojet e artizanatit
4. Teknologjia dhe Mjedisi
5. Njohuri rreth lëndës së drurit, mënyrat e prerjes dhe përpunimit
6. Gjetja e materialit dhe llojet e drurëve
7. Si përdoren mjetet e punës
8. Njohuri të përgjithshme për mprehjen e daltave
9. Punimi i drurit
10. Punimi drurit Siguria në punë, rreziqet
11. Kontrolli dhe mirëmbajtja e pajisjeve dhe vendit të punës

KAPITULLI 2 Teknikat e vizatimit dhe realizimi në dru e gur

1. Shpjegimi i vizatimit
2. Teknikat e vizatimit
3. Vizatimi i një modeli

KAPITULLI 1. NJOHJA DHE PËRDORIMI I MJETEVE TË PUNËS DHE LËNDA E PARË

Njohuri kulturore mbi artizanatin tradicional

Zbukurimet me gdhendje në dru në mjedise të banesës, në ene e orendi të jetes familjare, në mjetet e veglat e punës e të argëtimit etj., ka qenë një dukuri e veçantë, e spikatur e artit popullor shqiptar të traditës. Kjo mjeshtëri është e lidhur me përdorimin në shkallë të gjerë të lëndës së drurit si material ndërtimi; u zhvillua kryesisht në vise kodrinore e malore të pasura me pyje, krahina, ku krahas bujqësisë, blegtoria zinte një vend të konsiderueshëm.

Punimi i drurit kudo e pati zanafillën e rrugën e zhvillimit si një art baritor. Shumë objekte të vogla prej druri si kërraba e bariut, luga, furka, kuti duhani, lahuta, çifteli, fyej, kavallë, cyle një e dyjare, krehëra, stola, karriga, djepa, tabaka e kuti kafeje, rrathë kumbone të skalitura me me një mjeshtëri daltë artisti e shtëpiake, bëhej për të plotësuar nevoja të jetës familjare, duke shfrytëzuar kohën e lirë, sidomos në dimër kur njerëzit qëndronin në shtëpi; në ato raste bënë arka grash, tavane, dollape muri, korniza dritarësh, dyer e rafte, voza, enë e orendi të ndryshme të jetës familjare; punimet i zbukuronin me motive të frymëzuara nga natyra e dukurive etnografike të krahinës ose simbole të mitologjisë popullore shqiptare; paraqitnin në këto zbukurime: lule, gjethe, bimë e drunj të natyrës, gdhenden aty në relief pamjet e gjallesave që ishin më të dashura për ta si: sorkadhja, dhia e egër, gjarpëri, dashi, kau, kali, dielli, hëna, yjet, bariu i shenjtë, përfytyrime të ndryshme mitike. Diku kemi simbole të virtyteve të Shqiptarit, si mikpritja, trimëria, e shpirti luftarak i Shqiptarit, simbole kombëtare. Të përmendur janë mjeshttrat e punimit artistik të drurit në malësitë e Veriut, në Malësi të Gjakovës, në Malësinë e Sharrit (Maqedoni), në Dibër, në Çermenikë, në Labëri, në Mirditë, Malësi e Madhe.

Gdhendja u zhvillua dhe si mjeshtëri profesionale. Nga shek. XX e këtej mund të gjeje vise të ndryshme malore disa gdhendës profesionistë të drurit, sidomos tavane, trapazane, karrige etj. Po ka pasur dhe disa krahina ku punimi artistik i drurit, si mjeshtëri profesionale, mori zhvillim të gjerë. Mjeshttrat e përmendur dibranë, të Shpiragut pranë Beratit, ata të Shqipërisë Juglindore (Koniciotët) e ngritën artin e gdhendjes së drurit në një shkallë shumë të lartë; si mjeshttra profesionistë krijuan vepra artistike të pavdekshme. Këto tre krahina krijuan stile të veçanta të gdhendjes artistike të drurit. Dora dibrane e këtyre punimeve artistike i kishte përfaqësuesit e saj nga: Grykë e madhe e Dibrës, Gollobordë e Rekë (Maqedoni) po dhe në vise jashtë Dibrës si Tetovë e Kërçovë. Dora dibrane e zhvilloi veprimtarinë e saj në Shqipërinë Veriore, në Kosovë e në jug deri në Korçë. Këta ndahen në dy grupe: të specializuar në punime tavanesh, trapazanesh, verandash e ballkonesh, dyersh e copa për zbukurim me dru të pjesëve të veçanta të mureve të odës së burrave; veprimtarinë e tyre e zhvilluan kryesisht në trojet shqiptare e në Maqedoni. Në motivet zbukuruese të këtyre punimeve mbizotëron gjethi i lisit, po jo pak dhe motive të tjera bimore gjeometrike, apo figura të stilizuara nga natyra a mitologjia popullore, sivastika, trupa qiellorë, përdoren në jo më pak raste zbukurime me tejshtëpim; si material shërbeu më tepër druri i pishës. Veprat e tyre në drugdhëndje i gjejmë në Shkodër, Dibër, Prizren, Gjakovë, Prishtinë. Grupi i dytë u muar kryesisht me punime ikonostasesh e zbukurime në objekte kulturi, art që u zhvillua nga shek. XVIII-XIX. Këto vepra të tyre i ndeshim në Kosovë, në Dibër të Madhe, në Maqedoni e vise të tjera të Ballkanit. Bënë jo pak ikonostase. Tema e zbukurimeve në objekte të kultit më tepër janë biblike e

nën ndikimin e artit bizantin, por të gërshetuara dhe me skena realiste, me motive të natyrës dhe të jetës shqiptare. Në ikonostase, disa herë shihen skena biblike ku personat janë kostum veshur dibrani. Në disa ikono-me stase kanë vënë dhe emrat e tyre duke cilësuar se janë: "Dibranë", nga "Dibra", nga "Reka e Dibrës", "Shqiptari".

LLOJET E ARTIZANATIT¹

Prodhimet e dorës, në të cilën mbizotëron tradita apo vlerat artistike, janë shprehje e formave të mëposhtme të artizanatit:

Artizanati tradicional

Mund të përkufizohet tradicional krijimi i një produkti në përputhje me teknikat dhe metodat e përcaktuara gjatë kohërave, sipas zakoneve dhe traditave në nivel lokal apo rajonal, në një kontekst të caktuar historik ose kulturor. Prandaj produkti duhet të bëhet me teknikat dhe mjetet që respektojnë me besnikëri modelet, format, stilet dhe dekoracionet gjetur e ruajtur në koleksionet publike dhe private dhe / ose në dispozicion nga burime dokumentare që kanë të bëjnë me trashëgiminë kulturore.

Artizanati artistik

Artizanati artistik është produkt unik apo me numër të kufizuar, në çdo material, i cili është i shkëlqyer nga pikëpamja teknike, duke respektuar rregullat dhe vlerat, ka një formë inovative autonome dhe dallohet nga bukuria estetike (përmasa, ngjyrat, detajet dekorative). Komunikimi i zgjedhjes stilistike dhe / ose shprehja e gjuhës së krijuesit të saj, është një shembull i përkujdesjes dhe saktësisë së traditës ose propozimit në një nivel eksperimental të procedurave të reja të realizimit.

Konceptimi dhe produkti mund të kryhet nga një zejtar, i çfarëdo arsimimi për artin përmes një shkolle apo trajnimi.

Prandaj janë konsideruar punime artistike produktet me vlerë të lartë estetike apo frymëzuar nga forma, modele, dekore, stile dhe teknika që përbëjnë tiparet tipike të trashëgimisë historike dhe kulturore duke marrë parasysh risitë në përputhje dhe respektim të traditës artistike.

Artizanati inovativ

Mund të quhet inovativ realizimi i një produkti i cili paraqet më shumë ose më pak modifikime të thella në zgjedhjen dhe përdorimin e metaleve bazë dhe / apo lidhje metalike, të përpunuara në bazë të procedurave të veçanta, në vend të veçantisë së tyre estetike dhe funksionale, dhe / ose kritereve dhe / ose sistemeve të përdorura për të arritur atë, që përfaqësojnë elemente të reja në krahasim me të kaluarën.


¹ ¹ Disciplinare di produzione (ex art. 15, l.r. 10/07)- Lavorazione artigianale dei metalli comuni

TEKNOLOGJIA DHE MJEDISI

Teknologjia është një koncept i gjerë që merret me aplikimin e njohurive për veglat dhe profesionet, në funksion të kontrollimit dhe përshtatjes së rrethanave në mjedisin jetësor në përputhje me nevojat e tij. Një përkufizim i saktë për termin "Teknologji" nuk ekziston. "Teknologjia" mund t'i referohet objekteve materiale që përdoren nga njeriu, siç janë makinat, hardëaret, por mund të përfshijë edhe tema më të gjera, përfshirë sistemet, metodat e organizimit, dhe teknikat.

Aplikimi i teknologjisë nga njerëzimi filloi me shndërrimin e resurseve natyrale në vegla të thjeshta.

Zbulimi i aftësisë së kontrollimit të zjarrit rriti burimet e ushqimit dhe zbulimi i rrotës i ndihmoi njerëzit të udhëtonin dhe të kontrollonin mjedisin e tyre.



Teknologjia ka ndikuar shoqërinë në mënyra të ndryshme. Në shumë shoqëri, teknologjia ka ndihmuar në zhvillimin e ekonomisë (përfshirë ekonominë globale të ditëve të sotme) dhe ka lejuar rritjen e klasës shoqërore të lirë (në aspektin e kohës dhe punës). Shumë procese teknologjike çlirojnë produkte të padëshirueshme, të njohura si ndotje, dhe harxhojnë burimet natyrore, në dëm të tokës dhe natyrës. Zbatimet e ndryshme të teknologjisë ndikojnë në vlerat e shoqërisë dhe një teknologji e re shpesh shtron pyetje të reja etike.

Ndikimi i shoqërisë në mjedisin gjeografik. Mjedisin gjeografik jo vetëm ndikon mbi shoqërinë njerëzore por edhe vetë i nënshtrohet ndikimit të shoqërisë. Shkalla dhe karakteri i veprimit të shoqërisë njerëzore varet nga niveli i zhvillimit të shoqërisë njerëzore. Mjedisin gjeografik përmban vlerat natyrore, të quajtura burime. Ato ndahen në burime të papërtëritshme, të përtëritshme e të pashtershme.

- Në burimet e papërtëritshme hyjnë mineralet e dobishme, shfrytëzimi i të cilave ka ardhur vazhdimisht në rritje. Sot në botë nxirren rreth 150 miliardë tonë minerale në vit. Nga përpunimi i mineraleve prodhohen mjaft mbeturina në gjendje të gaztë, të lëngët apo të ngurtë duke shkaktuar ndotjen e mjedisit. Në ditët e sotme në botë burimet e energjisë së papërtëritshme siç është energjia e lëndëve djegëse fosile si qymyrguri e nafta përbën pjesën dërrmuese (rreth 90 %) të energjisë së përdorur.
- Në burimet e përtëritshme hyjnë tokat, bota bimore dhe bota shtazore. Dallimi kryesor i burimeve biologjike nga ato minerale qëndron në faktin se të parat mund të pakësohen dhe të shterohen, ndërsa këto burime mund të rigjenerohen dhe të shtohen. Mjaft i rëndësishëm është aspekti kohor i rigjenerimit të tyre. Sipërfaqja e pyjeve është pakësuar shumë në ditët e sotme. Proçesi i shpyllëzimeve dhe djegiet, ripërtëritja e ngadaltë, incidentet e zjarreve të shumta kanë sjellë shkatërrimin e pyjeve.

- Në burimet e pashtershme mund të konsiderohen ajri, uji, si dhe energjia diellore, e erës, e baticë-zbaticës etj. Energjia e drejtëpërdrejtë diellore, hidrike apo eoliane përbën një burim të pashtershëm në ekuilibër që hyn në mënyrë të natyrshme në bilancin e planetit.

Si dhe pse duhet ta mbrojmë mjedisin?

Mjedisi në të cilin jetojmë është shumë i rëndësishëm. Ai është burim i jetës. Mbrojtja e natyrës dhe e mjedisit konsiderohen si pjesa më e rëndësishme e jetës në planetin tonë. Te gjitha proceset që çojnë në një sistem ekologjik të suksesshëm janë të lidhura me programin për përcaktimin e strategjisë dhe zhvillimin e mëtejshëm të objektivave në ruajtjen e natyrës e të mjedisit. Po të njiheshin mirë të gjitha këto probleme sot nuk do të kishim shqetësimet e ndotjes së ajrit, ujit të tokës apo efektet e ngrohjes globale.

Dy janë drejtimet kryesore:

1. Ruajtja e mjedisit që ka si qëllim të kufizojë ndikimin e ndotjeve të industrisë, bujqësisë, transportit, ndërtimit e të tjera veprimtari të njeriut.
2. Ruajtja e natyrës që ka si qëllim të kufizojë deri në minimum ndryshimet në natyrë (ekosistemet) siç janë efektet e ngrohjes globale, ruajtja e shtresës së ozonit, pakësimi i emetimit të gazrave, evitimi i shirave acide.


Parimet më të rëndësishme të mbrojtjes së mjedisit janë:

- Shfrytëzimi racional i burimeve, reduktimi i emetimeve në ajër, reduktimi i ndotjes së ujit dhe tokës, dhe riciklimi i mbeturinave;
- Ruajtja e vlerave biologjike-ekologjike të mjedisit nëpërmjet ruajtjes së florës dhe faunës, dhe të vlerave të trashëgimisë natyrore
- Mbështetja në përdorimin e burimeve të ripërtërishme, bashkë-prodhimin e këtyre burimeve dhe të llojeve të ndryshme të energjisë;
- Promovimi i kursimit të energjisë.
- Shfrytëzimi i pajisjeve shtëpiake me efikasitet të lartë, të tilla si llambat e dritës;
- Reduktimi dhe riciklimi i mbeturinave.

Ndikimi i teknologjisë dhe shkencës në mjedis

Në çdo proces teknologjik skema është e njëjtë kemi lëndën e parë që shfrytëzohet (material, energji, ujë, etj) nëpërmjet një procesi dhe përftohet produkti si dhe prodhohen mbetje (të ngurta, të lëngëta dhe shkarkime në ajër). Të gjitha proceset prodhojnë mbetje. Kjo mbetje duhet minimizuar duke punuar si në drejtim të përdorimit më efikas të lëndës së parë por edhe të ripërdorimit apo riciklimit të mbetjeve për procese të tjera. Si rezultat i proceseve të ndryshme teknologjike shkaktohet humbje e burimeve natyrore dhe ndotje në mjedis. Shkaktohet humbje e burimeve natyrore pasi njerëzit nuk

Koncepti i teknologjisë bashkëkohore



janë racional dhe efektiv në planifikimet e tyre. ***Ndaj dhe ju kur të kërkonti lëndën e parëduhet që ta grumbulloni atë nga biznese serioze dhe ekologjike, apo edhe nëse e merrni vetë në natyrë të zbatoni parimet e qëndrueshmërisë. Po ashtu mos harroni se nga çdo prodhim i juaji mund të gjenerohen mbetje të cilat duhet të hidhen në vendet e duhura.*** Por nëse gjatë proceseve të punës tuaj prodhohen mbetje që mund të ripërdoren për produkte më të vogla (psh në përmasa) apo nga artizan të tjerë atëherë ju duhet ta merrni në konsideratë një gjë të tillë.

Drejt një mjedisi të qëndrueshëm

Historia dëshmon për lidhje të fuqishme midis ndryshimeve në sistemet ekonomike dhe integritetit të sistemeve ekologjike. Industrializimi nxiti rritjen ekonomike dhe me industrializimin erdhën mbetjet dhe ndotja. Shumica e problemeve mjedisore rrjedhin prej fitimit tonë, përdorimi dhe dhënia e burimeve natyrore për një stil jetese të begatshme.

Pasojat negative shpesh të paparashikuara errësojnë përparimin teknologjik. Sot 23% e popullsisë konsumon më shumë se gjysmën e burimeve të energjisë dhe më shumë se 1/3 e vendeve më pjellore dhe ndoshta 25% e popullsisë në botë vuan nga uria. Rritja e popullsisë është më e shpejtë në vendet e varfra dhe më pak të zhvilluara. Nëse ata do të futen në të njëjtin standart jetese si shumica e kombeve më të zhvilluara sot, atëherë kërkesat në burimet e kufizuara të planetit dhe mbetjet do të rriten duke çuar në degradimin e mëtejshëm të mjedisit.

Çfarë mund të bëjmë për zgjidhjen e kërkesave të brezave të ardhshëm dhe në të njëjtën kohë të ruajmë cilësinë e mjedisit?

Ndoshta mësimi më i rëndësishëm është që toka është burimi ynë i vetëm. Burimet në këtë planet janë gjithçka që ne kemi. Për disa prej këtyre burimeve si: metalet, mineralet dhe lëndët djegëse fosile, ritmi i ripërtëritjes nga proceset gjeologjike është i ngadalshëm dhe janë shumë të kushtueshme që të shfrytëzohen.

Teknologjia na ndihmon të kontrollojmë shumë sëmundje, të zgjerojmë njohuritë dhe të rrisim standartin tonë të jetesës. Por nga ana tjetër teknologjitë e reja zvogëlojnë vendet e punës dhe për rrjedhojë shtrenjojnë materialet. Praktikisht, një teknologji e re duhet t'i nënshtrohet një testimi të vazhdueshëm deri në stadin e operimit të plotë.

A mundet t'i përmbahemi kërkesës për burime të reja dhe të sigurojmë burime të mjaftueshme dhe mjedis të qëndrueshëm për brezat e ardhshëm?

Ne duhet të mendojmë për kërkesën duke u nisur nga dy perspektiva: kërkesa nga e tërë popullsia e globit dhe kërkesa për frymë. Ritmet e rritjes së popullsisë janë pakësuar gjerësisht në SHBA dhe në vendet e tjera më të zhvilluara dhe ndoshta do të ndalojnë rritjen brenda 4 viteve të ardhshme (duke mënjanuar emgrimin). Ky projektim është një shenjë e mirë për të ardhmen e kombeve më të zhvilluara pasi shihet si një rast i mirë në përballimin e kërkesës për burime të reja që kanë popujt e pazhvilluar. Nga ana tjetër, konsumi për frymë në kombet më të zhvilluara është një çështje krejt tjetër. Pavarësisht kostove në rritje, çdo brez ka një nivel në rritje të bollëkut. Rritja e konsumit do të çojë në zvoglim të burimeve. Ndaj shoqëritë e sotme nuk duhet të jenë thjesht konsumatore.

Në kohën e sotme disa njerëz kanë zvogëluar vullnetarisht konsumin e energjisë duke përdorur biçikletën ose triçikletë e vegjël për transport. Kështu ata konsumojnë më pak burime, krijojnë më pak mbetje dhe zvogëlojnë dëmet mjedisore. Një grup tjetër ka zgjedhur ndryshimin tërësor të mënyrës së jetesës së tyre dhe konsumit duke lënë jetën komforte dhe të rehatshme të shtëpisë për të jetuar në jetuar në rajonet më të thella të Alaskës ose vende të tjera veriore.

NJOHURI RRETH LËNDËS SË DRURIT, MËNYRAT E PRERJES DHE PËRPUNIMIT

Pemët dhe lënda e drurit e marrë nga pemët ndahen në dy kategori: në drunjë të fortë (drunj fletorë), të cilët kanë gjethe të plota, dhe drunjë të butë (drunj halorë), të cilët kanë gjethe në formë halash apo luspash. Ky klasifikim është shpesh herë jo i qartë, sepse nuk ekziston një lidhje direkte mes këtij klasifikimi dhe fortësisë apo butësisë së një druri. Në përgjithësi, drunjët e fortë janë më të ngjeshur se drunjët e butë, por disa drunjë të fortë janë më të butë se shumë drunjë që klasifikohen si të butë. Ka dy lloje drurësh: 1 që përdoret për dyer, dritare, tavanë dhe dysheme dhe 2 drurë që përdoren për mobilie dhe për gdhendje.

Unazat vjetore

Shumica e llojeve të drunjëve që rriten në zona me klimë të butë (ku kemi katër stinë në vit) krijojnë unaza vjetore të qarta, të cilat dallohen nga ndryshimi në ngjeshje dhe në ngjyrë mes drurit të formuar çdo vit dhe drurit të formuar më vonë gjatë stinës së rritjes.

Tiparet dalluese të llojeve të ndryshme theksohen nga ndryshimi në strukturën e unazave vjetore në rritje. *Nga numërimi i unazave vjetore mund të zbulohet moshja e pemës (një unazë krijohet në një vit).*

Trajtimi i tkurrjeve dhe bymimeve të drurit

Kur druri thahet në mënyrë jo të njëtrajtëshme, ai mund të shtrembërohet, mblidhet, përthyeret, të ndrydhet apo të krijojë gropa. Për të mundësuar prodhimin e objekteve prej druri me cilësi është e rëndësishme të vihen re që në fillim problemet që mund të ndikojnë në punën tuaj dhe të përgatiteni.

Pse tkurret apo bymehet druri?

Kur ai është akoma i gjallë, si pjesë e trungut të pemës, druri është një seri tubesh të holla ku qarkullon limfë dhe lëngje nga rrënjët e pemës deri tek degët. Pjesët e jashtme të trungut (shtresa limfatike), janë më aktive se pjesët e brendshme (zemra e drurit), që janë më afër qendrës së trungut.

Objektet e ndërtuara nga shtresat e brendshme (zemra e drurit) do jenë shumë më pak të ndjeshme ndaj fenomeneve që shkaktojnë tkurrje dhe bymime, sesa produktet e bëra nga druri i shtresave të jashtme (limfatike). Kjo, sepse druri i shtresave të brendshme (zemra e drurit) është më pak i prirur të mbajë lagështirë.

Drurët që përdoren për gdhendje janë të veçantë, të tillë si: arra (ka volum si trung, dhe përdoret për punime të mëdha; një ndër drutë më me vlera dhe shumë lehtë i gdhendshëm, i rezistueshëm), ulliri

(vetëm degët priten – përdoren për punime me torno, pastaj mund të gdhendësh motive), bliri, plepi, panja (është e vendit), ahu, lisi, pisha (tavane, rozeta) edhe bredhi.

Për më tepër, përdorimi i arrës në drugdhendje dikur ka qenë shenjë e statusit social për vetë cilësinë e drurit; është një dru që të jep mundësinë të fantazosh mbi të, të lozësh me të.

Vlerësim i lëndës Të kontrollojmë cilësinë e drurit për plasaritje, lagështi (stazhonim i duhur)- element që duhen kontrolluar që në fillim të procesit përndryshe shkon puna dëm. Në rast se druri ka lagështi punimi mund të deformohet, mund të plasaritet.

Hapi 1: Krijoni një projekt vizual të objektit që do të gdhendësh.

Hapi 2: Vizatoni projektin në letër. Një miniskicë. Mbase përfundon skicën fillon dhe e hedh në dërrasë.

Hapi 3: Ndani copën e drurit në 2 ose 4 pjesë në varësi të objektit, dhe vizatoni në një pjesë të drurit objektin që dëshiron të gdhendësh.

Hapi 4: fillon puna praktike me pajisjet përkatëse. (dalta, çekiç, fiksime të drurit).

Ushtrime sharrimi, lëmimi dhe shpimi

- a) Element ushtrimi
- b) Mbajtëse pecetash
- c) Mbajtëse çelësash prej druri
- d) Mbajtëse lapsash në formë zar
- e) Kutitapsash

GJETJA E MATERIALIT DHE LLOJET E DRURËVE

Gjetja e materialit bëhet në natyrë duke iu nënshtruar proceseve të prerjes dhe dërgimit për përpunim në kombine. Më pas bëhet trajtimi i tij me kimikate për ruajtjen nga krimbi, stazhonimi i tij dhe çarja e trupave në dërrasa. Pajisjet që duhen që nga prerja e drurit e deri tek përpunimi i tij janë motosharrat, sharrat e sharrëxhinjve, pajisjet dhe makineritë që duhen në një repart marangozi për përpunimin e lëndës drusore(plani, shiriti, groseta, freza, gonjastra, radiali dhe shumë vegla dore monofazë).

Tipet e drurit për gdhendje

Zgjedhja e duhur për dru gdhendje mund të varet nga shumë faktorë si:

-A është druri i butë mjaftueshëm për tu prerë lehtë me thikë gdhendjeje?

-A na nevojiten dalta dhe çekiç druri?




-A do të marrim në përfundim një produkt natyral që tregon drurin, apo do të jetë një pikturë?





Disa drugdhendës zgjedhin forma interesante shkopinjshe apo trungjesh. Një trung i sapo prerë mund të paraqesë probleme pasi është ende i mbushur me një masë të madhe të lagështisë. Nëse trangu thahet shumë shpejt mund të plas keq. Është më mirë të lihet të thahet për një periudhë të zgjatur kohe deri sa të arrijë një nivel të pranueshëm të përmbajtjes së lagështisë për të parandaluar plasaritjet e padëshiruara.

Për gdhendje të vogla, objekte artizanale dore, të tilla si rosë apo zogj, karaktere figurash, dhe gdhendje të vogla, druri bas është një zgjedhje e shkëlqyer. Ai është i butë dhe i lehtë për të gdhendur, gërryerja e afërt bën detaj të vogla gdhendjeje; ka pak nyje dhe është i qëndrueshëm kur thahet. Megjithatë, butësia e tij e bën të vështirë për të aplikuar ngjyrime në mënyrë të barabartë në një sipërfaqe të gdhendur apo të arrijmë një lustër me shkëlqim. Shumica e këtyre lloj drurëve të gdhendur pikturohen.

Për skulpturë me pamje natyrore, arra, druri i kuq, qershia, japin modele druri tërheqëse të pasura me ngjyra. Arra, druri i kuq, qershia janë të pasura me ngjyrë, pak vështirë për t'u gdhendur për shkak të dendësisë së kokrrizës por realizohen mirë. Dalta konkave dhe çekiç druri janë të nevojshëm për këto lloj drurësh.

Në tabelën më poshtë jepen disa karakteristika kryesore dhe vështirësi që mund të hasen gjatë gdhendjes së disa lloj drurësh.

Tipi	Pamje	Karakteristika	Vështirësia e gdhendjes	Përbërja kokrrizore
Druri Bas		<ul style="list-style-type: none"> -Ngjyrë krem; - I lehtë për tu gdhendur, -I shkëlqyeshëm për easy to carve, excellent for skulptura të gdhendura me thikë dhe të pikyuruara 	I lehtë	Mesatare
Qershia		<ul style="list-style-type: none"> - Kafe e kuqërremtë; - I shkëlqyer për skulptura natyrale 	Shumë i vështirë	e imët
Druri i kuq		<ul style="list-style-type: none"> - Kafe e kuqërremtë e errët - Zgjedhje e shkëlqyer për skulptura natyrale 	Mesatar	Mesatar

Panja		<ul style="list-style-type: none"> - Ngjyrë krem; - Shumë i vështirë për t'u gdhendur por realizohet mire 	Shumë i vështirë	e imët
Lisi (i bardhë)		<ul style="list-style-type: none"> - Ngjyrë kaki; - Shumë i vështirë kur thahet 	Shumë i vështirë; Gdhendet lehtë kur është jeshil	Mesatar
Pisha		<ul style="list-style-type: none"> - Aromatik, ngjyrë krem, i butë, i mirë për gdhendje me thikë, rritja e shquar e unazave të drurit e bën të vështirë për tu prerë. 	I lehtë	Mesatar
Arra (e zezë)		<ul style="list-style-type: none"> - Ngjyrë kafe e errët, - I shkëlqyer për skulptura natyrale - Realizohet mirë 	I vështirë	Mesatar

Si përdoren mjetet e punës ²

Kontrolli dhe mirëmbajtja e makinerive dhe veglave të punës

Është një proces shumë i rëndësishëm, pasi ka të bëjë me zgjatjen e jetës së makinerive, si dhe është i lidhur me kujdesin për shëndetin.

Në momentin që makineritë janë të centruara, të grasatuara, të mprehura mirë ato punojnë mirë dhe pa anomalira. Në këtë mënyrë përjashtohen, ose janë shumë të pakta dhe mundësitë e prerjeve.

Makineritë kontrollohen për mirëfunktionimin e tyre para fillimit të punës. Mbas punës pajisjet duhet të pastrohen me ajër dhe të grasatohen sa herë kjo është e nevojshme.

Vegla pune dhe mjete matëse të rëndësishme për të qënë pjesë e arkës së veglave të kursantëve

1. Çekiçi 200 g
2. Lima gjysemërrumbullake
3. Kacavidha, për kanal të madh
4. Kacavidha, për kanal të vogël
5. Shënuesi
6. Bulino
7. Morsetë
8. Pincë
9. Mjet vijëzues
10. Sharrë e imët (e drejtë)
11. Skuadër
12. Metër celiku
13. Tapa Zmeriluese
14. Bazë kompensate
15. Copë (Stof)

Secili kursant, përpara mbarimit të çdo orë praktike duhet të kontrollojë nëse arka e veglave të punës është e plotë duke u bazuar tek kjo listë.

Matja/ Shënimi

Matja përcakton përmasat reale të materialit të punës (p.sh. gjatësinë, gjerësinë, lartësinë) me ndihmën e instrumentave matës. Një vizore çeliku mund të përdoret për të përcaktuar gjatësinë e materialit të punës në mm.


² Përpunim Druri- Libri i nxënësit prodhuar për "Arsimi Profesional në Shqipërinë Verilindore", pjesë e programit Zhvillimi i Burimeve Njerëzore/Arsimi Profesional në Shqipëri, i financuar nga Qeveria Gjermane

Lëmimi

Me limë realizohen sipërfaqe të rrafshta, kënddrejta, paralele ose të harkuara. Këto proçese varen nga masa, forma, saktësia e shtrirjes, si dhe cilësia e sipërfaqes.

Përshkrimi i punës së limës

- ✘ Dhëmbët e limës cifëlzojnë lëndën në të cilën punohet
- ✘ Numri i dhëmbëve të limës për çdo cm të gjatësisë së limës përcakton numrin e goditjeve.
- ✘ Ky numër goditjesh shënohet në limë.








Llojet e limave

Llojet e limave përcaktohen nga format e prerjeve tërthore, madhësive dhe numrit të goditjeve, si dhe nga mënyra e prodhimit të tyre: të frezuara apo të goditura.

Punimet e ashpra kërkojnë heqje të madhe ashklash, dmth. këtu kërkohen lima me numër të vogël goditjesh (1 ose 2), të cilat quhen lima të ashpra.

Sipërfaqet e lëmuara arrihen nga heqja e pakët e ashklave. Për këtë proçes përdoren lima me numër të madh goditjesh (3 ose 4). Ato quhen lima lëmuuese.

Lima e merr emrin nga forma e prerjes tërthore:

1. Limë katrore 
2. Limë rrumbullake 
3. Limë trekëndëshe 
4. Limë gjysëmrrumbullake 
5. Limë e sheshtë 

Mirëmbajtja e limës

Për pastrimin e saj mund të përdoret një furçë lime ose një furçë tunxhi. Gjatë lëmimit të sipërfaqeve të mëdha mund të ndodhë që pjesa e mesme e fletës së limës të mos mund të dalë nga qoshet e objektit.

Këtu ashklat pothuajse ngecin mes limës dhe sipërfaqes së objektit. Gjatë zmerilimit me letër zmerile formohen kështu puprriza që gërrvishtin sipërfaqen.

Për ta shmangur këtë, lima lyhet me shkumës. Ashklat kapen për shkumës dhe kështu ulet dëmi që ata mund të sjellin. Shkumësi gri i konsumuar hiqet dhe lima lyhet përsëri me shkumës të ri. Ky proces bëhet në etapën e fundit të lëmimit.

Limat vjetrohen dhe humbasin mprehtësinë. Nëse mbajmë një limë të vjetër dhe një të re pak pjerrtas kundrejt dritës, mund të vihet re lehtë që lima e vjetër është më e shndritshme dhe e zhveshur se e reja. Lima mund të shkatërrohet lehtë tek lëndët e forta. Nëse limojmë mbi një cilindër të forcuar, në një këllëf të fortë apo nofulla morse të forta, vihet re që lima rrëshqet. Dhe nëse vërejmë më nga afër, shikojmë gjurmët e shndritshme dhe të zhveshura në fletë. Përpara limimit duhet të kontrollohet patjetër, se çfarë materiali ka objekti që do përpunohet.

Mbaj mend: Të mos lëmohen asnjëherë sipërfaqet e forta.

Pozicioni i punës gjatë lëmimit

Mbajtja e limës:

Dora e djathtë mban bishtin e limës, ndërkohë që që fundi i bishtit mbështetet tek gishti i madh i kësaj dore.

Pozicioni gjatë lëmimit

Lërimi kërkon ushtrim të madh force dhe lëvizje të shpetja të të gjithë trupit, që me dhëmbët e limës të mund të largohen ashklat nga objekti. Prandaj është e nevojshme të mbahet pak distancë nga objekti, në mënyrë që lima të mund të lëvizet lirshëm dhe në masën e duhur.

Ushtrim praktikimi

Sharrimi

Sharrat e dorës

Me sharrën e dorës ndahet materiali në një proces ashkëlzues/cifëlzues. Me anë të sharrimit mund bëhen sharrime në gjatësi ose të realizohen çarje.

Sharra e dorës përbëhet nga fleta e sharrës, doreza dhe harku.

Fletët e sharrës presin vetëm në një drejtim. Ata kanë dhëmbë të vegjël që vijnë njëri pas tjetrit. Gjatë sharrimit drejtimi i dhëmbëve duhet të tregojë përpara. Distancën mes dhëmbëve e quajmë ndarje dhëmbësh.



Fletët e sharrave kanë ndarje të ndryshme dhëmbësh: të rrallë, të mesme, të imët

Ndarja e dhëmbëve	Përdorimi
E rrallë	Për lëndë të buta dhe prerje gjatësore (të gjata)
E mesme	Për lëndë me fortësi të mesme, për prerje gjysëmngjatësore
E imët/e shpeshtë	Për lëndë të forta ose të holla, prerje të shkurtra

Sharrimi me dorë

- Objekti fiksohet në morsë në mënyrë të mos tundet apo të rrëshqasë
- Të limohet me limën trekëndëshe pasi ndihmon drejtimin e sharrimit
- Të sharrohet me lëvizje të njëtrajtëshme. Dhe gjatë sharrimit të shfrytëzohet e gjithë gjatësia e fletës së sharrës.
- Sharra të mbahet në të njëjtën mënyrë si lima me numer 1 dhe 2.
- Lëvizja bëhet duke vënë në punë gjithë krahun duke u ndihmuar edhe nga trupi.
- Lëvizja përpara bëhet me ushtrim force mbi fletën e sharrës– lëvizja mbrapa pa forcë. Forca ushtrohet nga dora tek doreza, ndërsa dora tjetër mban harkun e sharrës tek pjesa e përparma.

Këshillë - Fleta e sharrës nuk duhet të krijojë qoshe e kanale penguese, prandaj sharra të mbahet drejtë dhe të shtyhet në mënyrë të njëtrajtëshme.

Ushtrimi: Gdhendja me dalta

Gozhda si mjet lidhës

Mjetet më të thjeshta për lidhje druri janë gozhdët. Ato prodhohen mekanikisht nga teli i celikut. Sipas formës së kokës, ato i ndajme në gozhdë me kokë të rrafshët, me kokë konike ose me kokë të shtypur. Këto të fundit përdoren, kur pas nguljes nuk duhet të duken. Vrimat që lënë gozhdët mbyllen me stuko druri.

Qëndrueshmëria e lidhjeve ve me gozhdë varet nga forca mbajtëse e gozhdëve. Kjo, nga ana tjetër, varet nga forma dhe madhësia, nga lloji i drurit, nga lagështira e drurit, si dhe nga pozicioni i gozhdëve në lidhje me drejtimin fijeve (fibrave të drurit).

Trashësia e gozhdëve

Trashësia e gozhdëve (diametri) duhet t'i përshtatet trashësisë së drurit me të hollë të lidhjes dhe duhet të jetë maksimalisht sa 1/10 e trashësisë së dërrasës.

Gjatësia e gozhdëve

Gjatësia e gozhdëve duhet të jetë mesatarisht sa trefishi i trashësisë së objektit që lidhet.

Radhitja e gozhdëve varet nga drejtimi i fijeve (fibrave) të drurit. Si rregull i përgjithshëm vlen: Largësia minimale nga buza e dërrasës= 5- fishi i diametrit të gozhdës.

NJOHURI TË PËRGJITHSHME PËR MPREHJEN E DALTAVE

Daltimi

Dalta është një vegël e thjeshtë në formë pyke, që shtyhet në lëndë me goditje të forta çekiçi. Me të druri apo metali mund të ndahet por edhe të ashkëlzohet. Daltimi po bie gjithnjë e më shumë në harresë, sepse vegla të tjera si sharra, gërshëra dhe makinat e zmerilimit janë shumë herë më të sakta dhe më të shpejta.



Dalta përdoret sot vetëm për sipërfaqet që arrihen me vështirësi. Për realizimin e ndarjeve hapen vrima në distanca të vogla nga njëra- tjetra dhe më pas, lidhjet mes tyre daltohen. Dalta goditet gjithmonë vertikalisht me çekiç. Gjatë heqjes së një pjesë, dalta mbahet pak pjerrtas dhe me të dyja duart që të mund të arrihet një drejtim i mirë.

Lloji i veglës	Cilësitë	Përdorimi
Daltë e sheshtë	Me teh të gjerë dhe të drejtë	Për përpunim sipërfaqes dhe pastrim ciflash
Daltë kryqe	Me teh të ngushtë dhe të drejtë	Për realizimin e kanaleve të ngushta pa harqe
Daltë ndarëse	4 teha të drejtë 4 anët hollohen drejt bishtit	Për procesin ndarës tek pjesa me vrima e objektit. Diametri i vrimës më i madh se Gjerësia e daltës ndarëse

Rregulla pune

- Të përdoren vetëm dalta me teh pa të meta dhe një çekiç po ashtu pa të meta.
- Koka e daltës nuk duhet të jetë e ciflosur
- Të mbahen syze mbrojtëse dhe dorashka
- Nëse është e mundur të përdoret daltë me mbrojtëse dore
- Gjatë daltimit, shikimi të jetë i përqëndruar gjithmonë tek tehi



Mprehja e daltave dhe fillimi i punës

Mprehja e daltave për punimin e drurit është një proces sa i lehtë në dukje, aq dhe i vështirë për tu realizuar. Është një proces shumë i rëndësishëm, pasi nëse nuk janë të mprehta daltat nuk mund të punohet druri. Mprehja realizohet me anë të gurëve zmerilë, gurëve që punohen me vaj, etj.

PUNIMI I DRURIT

Druri është i përbërë nga qeliza gjatësore shtrirë paralel me njëra-tjetrën dhe që vazhdojnë në një drejtim afërsisht të drejtë nga rrënjët e pemës drejt kulmit të fletës.


(Shënim: drurët gjithmonë ndjekin anët paralele. Shpesh marrin pak kënd lart ose poshtë, ose mund të marrin edhe kthesa, përkulje të papritura).



Gdhendja e gurit:

Për të gdhendur në mënyrë efektive, duhet të përdoret si mjet teh i mprehtë që duhet të lërë një prerje të shkëlqyeshme nëpër dru, pa vija të bardha.

Për të përcaktuar drejtimin e drurit, shikohet gjatësia e qelizave të fibrave. Vijat e errëta të unazave vjetore mund të ndihmojnë të tregojnë drejtimin e drurit.



Gdhendja në një drejtim mbi linjat paralele të drurit:

Vini re, në qoftë se druri duket sikur po plasaritet dhe mjetet janë të mprehta, atëherë drejtimi i punës është i gabuar. Druri duhet kthyer në drejtim të kundërt për tu punuar. Gjithashtu mund të gdhendet në mënyrë diagonale në të gjithë drurin dhe madje edhe paralel me të, por në qoftë se gdhendet në drejtim të kundërt ai vetëm do të ndahet dhe plasat.



Përdorimi i thikës:

Kur punohet me gdhendje të vogla që mund të mbahen në dorë, druri mbahet në dorën e majtë dhe thika në të djathtë.



Mbahet dora e majtë prapa thikës dhe përdoret gishti I madh në anën e hapur të tehut të veprojë si një levë për të kontrolluar prerjen. Me gishtin e palëvizshëm, rrotullohet dora dhe kyçi për të bërë prerjen. Në këtë pozicion, nëse thika rrëshqet nuk do të priheni. Thika asnjëherë nuk duhet të dalë jashtë drurit. Thika duhet mbajtur njëloj sikur qërohet një mollë duke u kujdesur që të mos priten gishtat.



Përdorimi i daltave:

Mbahet fort doreza me pëllëmbën e dorës së djathtë për të shtyrë daltën;

Mbahet boshti metalik me dorën e majtë për të drejtuar prerjen.

Me dorën e majtë mbahet fort në mënyrë të vendosur boshti metalik mbi dru, mund të përdoret si një frenë në mënyrë që mjeti të mos dalë jashtë kontrollit kur të shtyhet përpara. Përdoret pesha e trupit për të ndihmuar shtyrjen e veglës.



Skicimi:

Hiqen sa më shumë copëza druri që të jetë e mundur me një shirit ose zinxhir sharrë. Gabimi më i zakonshëm i herës së parë i drugdhendësit është se ata nuk janë agresive sa duhet në largimin e materialit. Kështu asnjëherë nuk marrin në fund formën katrore të bllokut origjinal. Nuk duhet patur frikë të punohet për rrumbullakimin e formave bazë.

Fillohet puna me dalta të mëdha U për të hequr masën maksimale nga materiali. Fillimisht krijohen forma të përmasave të mëdha. Një mënyrë e mirë për të bërë këtë është të përcaktohen rrafshet kryesore të objektit të gdhendur. Punohet nga format e mëdha drejt detajeve të vogla. Nëse nuk janë krijuar forma të mëdha, asnjë detaj i bukur i shtrirë në majë nuk do të shpëtojë format e keq-përcaktuara.

Shtimi i detajeve:

Pasi struktura është krijuar, mund të fillohet bërja e detajeve më të vogla me dalta U. Daltat V dhe daltat e vogla U ndihmojnë të përcaktojnë forma të vogla. Në këtë pikë, është e rëndësishme për të mbajtur mjete si tehët e mprehjes në qoftë semendohet të lihen shenja si thurrije/ endje përfundimtare.

Gdhendjet mund të jenë si gdhendja e një margaritë(lule dele) me dopio petale.



RREGULLA TË PËRGJITHSHME SIGURIE ³

Rregulla të përgjithshme sigurie

Pjesa më e madhe e punishteve kanë rregullat e tyre të veçanta të sigurisë, të cilat zakonisht vendosen dukshëm në mure. Në mënyrë që të punoni në kushte sigurie, duke shmangur lëndimet për veten apo për ata me të cilët punoni, është e nevojshme të njihni rreziqet dhe të dini se si mund të shmangen apo të eliminohen ato. Punëtorët pa përvojë, në mjedise të reja, janë më shpesh të përfshirë në aksidente - zakonisht për shkak se rregullat e sigurisë ose nuk njihen, ose nuk ndiqen. Ndaj duhet të mësoni këto rregulla:

- Mësoni se çfarë duhet të bëni në rast zjarri apo aksidenti.
- Gjithmonë përdorni mjetet e sigurisë.
- Informoni menjëherë instruktorin në lidhje me çdo gabim që ndodh me përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve.
- Mos vraponi asnjëherë në repartet e punës;
- Mbajtja pastër dhe me rregull e repartit të punës

Një bango pune e rregullt e bën punën më të lehtë. Veglat, instrumentet matëse dhe skicat e përdorura për kryerjen e punimeve, duhet të kenë vendin e tyre mbi bangon e punës.

Një bango pune jo e rregullt sjell dëmtimin e veglave dhe të instrumenteve matëse. Kjo mund të sjellë gabime gjatë punimit ose deri në aksidente.

Kujdesi për veglat e dorës

- Asnjëherë mos përdorni vegla të dëmtuara.
- Çekiçet me koka të lirshme janë veçanërisht të rrezikshëm.
- Fleta e sharrës nuk duhet të krijojë qoshe e kanale penguese, prandaj sharra të mbahet drejtë dhe të shtyhet në mënyrë të njëtrajtëshme.
- Daltat me kokë të deformuar mund t'ju dëmtojnë duart.
- Asnjëherë mos përdorni lima që s'kanë doreza.
- Gjithmonë sigurohuni që doreza të jetë e fiksuar mirë mbi limë dhe të mos jetë e dëmtuar.
- Gjatë punimit me daltë, sigurohuni që ciflat të mos godasin personat që janë afër.
- Asnjëherë mos përdorni një makineri pa leje nga instruktori juaj, i cili do të sigurohet që ju keni aq njohuri sa të filloni punën pa frikë.

³ Përpunim Druri- Libri i nxënësit prodhuar për "Arsimi Profesional në Shqipërinë Verilindore", pjesë e programit Zhvillimi i Burimeve Njerëzore/Arsimi Profesional në Shqipëri, i financuar nga Qeveria Gjermane

- Mos hidhni graso apo vaj mbi dyshemën e repartit të punës – një sipërfaqe e rrëshqitshme është tejet e rrezikshme. Vaji ose grasoja duhen pastruar sapo ato të derdhen mbi dyshemë.
- Kini kujdes nga shufrat metalike, etj., të cilat dalin nga makineritë, morsetat dhe raftet e veglave.
- Veglat, pajisjet etj., duhen vendosur në vendet e tyre të posaçme pas përdorimit.

Sasi e kufizuar e lëndëve në vendin e punës.

Në vendin e punës duhet të mbahen vetëm ajo sasi lëngjesh dhe gazrash të djegshme, që nevojiten për ecurinë e punës së përditshme. Vendi i punës dhe dhoma e punës duhet të pastrohen rregullisht nga pluhurat (pastrim pluhurash me fshesë industriale të kontrolluar).

Situata rreziku

- Gjatë përpunimit të drurit mund të shfaqen pluhura druri të lagështa, të cilat gjatë kontaktit me ajrin krijojnë përzierje shpërthyes (psh gjatë zmerilimit dhe frezimit)
- Gjatë magazinimit të pluhurave të drurit, nga prurja e vatrave vetedjegëse, mund të ndodhin shpërthime
- Veçanërisht gjatë sprucimit mund të priten rreziqe shpërthimi në fushën areostatike.
- Gjatë punëve pastruese (të pajisjeve dhe veglave) me tretësira shfaqen gjithashtu avuj lehtësisht të çlirueshëm në masa të rrezikshme

Masa mbrojtëse

Masa sigurie teknike dhe organizative

- Përdorimi i mjeteve të punës me thithje të integruar dhe akumulator pluhuri
- Ventilatori
- Minimizimi/kufizimi i punëve shtresëzuese dhe ngjitëse, respektimi i rregullave përkatëse të udhëzimeve të ndërmarrjeve rreth, përdorimit të lëndëve të rrezikshme“ dhe „punëve me lyrje dhe llakosje“ (për salla)
- Të mos hahet, pihet, pihet cigare apo teshtihet. Të mënjanohet prekja e syrit dhe lëkurës! Të mënjanohet thithja e avujve dhe aerostatikes! Pas çdo punë dhe përpara çdo pushimi, të pastrohen pjesët e papastra të trupit! Të përdoren solucione pastrimi për lëkurën!
- Në raste zjarri – për aq kohë sa nuk përbën rrezik – të bëhen përpjekje për shuarje zjarri.
- Gjatë largimit të produkteve të derdhura, të përdoren syze, dorashka dhe në rast sasive të madhe, mbrojtje për kanalet e frymëmarrjes. Produkti është i djegshëm. Gjatë zjarrit krijohen avuj të rrezikshëm (psh.monoksid karboni)! Në rast rënie zjarri në afërsi të freskohet mbajtësja/ena me spërkatës uji! Rrezik shpërthimi dhe pëlcitjeje nga ngrohja!
- Të mbahen parasysh planet e alarmit, largimit dhe shpëtimit. Të alarmohet zjarrëfiksa.

Pajisje personale sigurie

Mbrojtja e syve: Gjatë punës me makina a pajisje të ndryshme, në rastet kur rrezikojnë të na bien cifla në sy, duhet të mbahen syze me strehë anësore mbrojtëse.

Mbrojtja e lëkurës: Për pjesët e zbuluara të trupit të përdoren dorashka.

Mbrojtja e trupit: Të mos mbahen veshje që ngarkohen lehtë elektrikisht (jo veshje sintetike, por me përqindje të madhe pambuku!)

Mbrojtja e këmbës: Të mbahen këpucë.

Ndihma e shpejtë

Tek çdo ndërhyrje për ndihmë të shpejtë: Të mbahet parasysh vetmbrojtja, trajtimi mjeksor, masat e menjëhershme të shpëtimit të jetës si “vendosja në pozicion stabil”, “rigjallërimi i zemrës dhe mushkërive”, “luftimi i tronditjes”, të cilat duhet të zbatohen në varësi të situatës. Plagët të mbulohen në mënyrë sterile. Të kujdesemi për qetësinë/rehatinë e trupit dhe të mbrojmë nga humbja e nxehtësise.

Pas kontaktit me sytë: Të shpërlahen menjëherë kapakët e hapur të syve me ujë të bollshëm (për rreth 10 min).

Pas kontaktit me lëkurën: Rrobat e papastra, të brendshmet dhe këpucët, të hiqen menjëhere. Të shpëlahet lëkura me shumë ujë.

Pas frymëmarrjes: I dëmtuari të hiqet nga zona e rrezikut. Marrje e ajrit të pastër nëpërmjet frymëmarrjes ose thithjes se ajrit të pastër. Të përdoren ndihma për frymëmarrjen (vetëmbrojtje).

Pas gëlltitjes së lëndëve të rrezikshme: Shpëlarje e menjëherëshme e gojës. Uji të pihet në gllënjka të vogla.

Largimi i mbeturinave

Pluhuri i drurit dhe i tallashit të grumbullohet në kontenier silazhi, kontenier, qese për pluhur etj. dhe të riciklohet pa pluhura.

Të mos derdhen në lavamane apo koshe mbeturinash! Mbetje lëndësh/produktesh, paketa me mbeturina, materiali i papastër dhe pecetat e pastrimit të mblidhen për t’u larguar në kontenierë me kapak, rezistentë ndaj djegies.

Këshilla praktike

- Gjithmonë vendosini veglat djathtas morsës
- Instrumentet matëse vendosini majtas morsës, mbi një sipërfaqe të butë
- Veglat e punës duhen vënë me rregull mbi bangon e punës dhe në kutitë e veglave sipas madhësive të tyre
- Veglat e punës dhe instrumentet matëse duhen mbajtur të ndara nëpër kutitë e veglave
- Mbajini pastër veglat e punës
- Njoftoni instruktorin për çdo dëmtim të veglave apo instrumenteve matëse
- Pas përfundimit të punës, instrumentet matëse duhen pastruar dhe grasatuar
- Hiqeni nga morsa materialin e punës kur duhet ta matni atë ose kur largoheni nga bangoja e punës
- Koka e bulinos dhe fytyra e çekiçit duhet të jenë të pastra nga ciflat dhe grasoja. Sigurohuni që doreza e çekiçit është e fiksuar te koka e tij!
- Përdorni vetëm vegla pune që janë në kushte optimale
- Sigurohuni që t'i përdorni veglat me kujdes
- Përdorni vetëm ato vegla dhe makineri për të cilat keni marrë shpjegime të përdorimit të tyre

EDUKIM FIGURATIV⁴

SHPJEGIMI I VIZATIMIT

Në fund të temës kursanti duhet të jetë i aftë:

1. Të dallojë teknikat kryesore të artit dhe veçoritë e tyre
2. Të dijë të përzgjedh bazën materiale për procesin e punës
3. Të jetë i aftë nëpërdorimin e mjeteve që i nevojiten

VIZATIMI ME LAPS (LETRA, GOMA)

Lapsi është një mjet mjaft i hershëm që përdoret për shumë procese, gjithashtu për të vizatuar. Përdorimi i lapsit në vizatime nuk shihet thjesht si një mjet mekanik, por një mjet i fuqishëm shprehës me të cilin janë krijuar veprat e artit.

VETITË E LAPSIT:

- Është i thjeshtë në përdorim.
- Jep mundësi për korrigjim gjatë punës
- Përdoret në disa lloje letrash.
- Gjatë përdorimit krijon efekte tonale, lëvizje nëpërmjet linjave, kontraste grafike, etj.

Tonaliteti i lapsit ka të bëjë me mënyrën e përdorimit, llojin e tij dhe konceptit të veprës së autorit. Duke qenë se është i thjeshtë dhe i lirshëm në përdorim, me të nëpërmjet vijave (linjave) krijojmë variante nga më të ndryshme teksturash dhe sfumaturash me gisht apo gomë.

LETRA

Letrat e vizatimit janë të formateve të ndryshme dhe të cilësive të ndryshme. Por, kur ne vizatojmë duhet të zgjedhim një letër jo me llustër, por poroze (të ashpër) që pastrohet lehtë nga goma dhe që mban gjurmët e lapsit, përjashtoj rastin kur ne punojmë me penë. Dimensionet (përmasat) zgjidhen sipas veprës që kemi ndërmend të realizojmë.

GOMA

Edhe goma është mjet pune në shërbim të lapsit (vizatimit) që përdoret për të pastruar, për sfumatura, por nëpërmjet saj ne krijojmë edhe efekte kontrastuese.

Goma është bashkëudhëtare e punës në vizatim sepse duke pastruar ajo thith çdo gjurmë të lapsit që nuk na nevojitet.

Ushtrim: Vizatoni në fletoren e vizatimit një sferë, një kub, një cilindër dhe trajtojini ato me dritë hije.

⁴ Hasani, A. (2009): "Edukim figurativ 6", Uegen

SKULPTURA (DRU, GUR, BAKËR)

Futet në degët e artit figurativ tripërmasor, sepse plotëson tri përmasat (lartësi, gjerësi, thellësi). Forma shprehëse e saj është vëllimi dhe lëvizja. Edhe skulptura ka origjinë të hershme ashtu sikurse edhe piktura.

Brenda llojit të saj kemi:

- relievin (skulptura e rrafshët)
- altorelievin (është një lloj relievi i lartë)
- basorelievin (lloj relievi i ulët)

Materialet që përdoren për skulpturën janë: druri, guri, allçia, bronxi, bakri, mermeri etj. Në të cilën një pjesë e këtyre materialeve realizohet me gdhendje dhe pjesa tjetër punohet me allçi sipas nevojave. Skulpturën e kemi nga më e vogla (që quhet figurinë) deri tek skulptura monumentale (me përmasa shumë të mëdha), si psh. Monumenti i Gjergj Kastriot Skënderbeut (Tiranë, Krujë, Kosovë) apo i shenjtores Nënë Tereza.

Gdhendja realizohet nëpërmjet daltave të llojeve të ndryshme të kushtëzuara nga materiali që disponojmë.

Ushtrim:

Ndërtoni mbi një kompensatë disa forma gjeometrike me plastelinë (kon, cilindër).

STAMPIMI (PIROGRAFI, GUR, DRU)

Ekziston si një mënyrë e vjetër përdorimi nga njerëzit për të krijuar variacione të ndryshme të dekorimit në përgjithësi. Është një nga variantet e modeleve të tekstileve të kompozuar nga piktorët. Stampimi lehtëson mundësinë e gjetjes së shumë formave të dëshiruara, por të stilizuara për t'i dhënë gjithmonë vlerën e artit.

Modelet mund të bëhen me karton, me materiale të gomuar duke i prerë dhe duke i dhënë forma të ndryshme sipas zgjedhjes së artistit për atë që dëshiron të bëjë dhe të stampojë në karton, dru, gur, etj.

Si veprohet:

Mbasi e kemi vizatuar formën që dëshirojmë e presim sipas linjës me kujdes. E vendosim kartonin mbi materialin që do të stampojmë dhe e sprucojmë me ngjyrë nga lart ose me sfungjer të lyer me bojë ose nëpërmjet lapsit. Shpërndarjen e dekorimit e bëjmë sipas idesë që kemi projektuar.

Krijimi i stampave me gdhendje

Para se të krijojmë stampa me gdhendje në rradhë të parë duhet të kemi zgjedhur motivin që do të gdhendim. Zgjedhja e motivit duhet të jetë e përshtatshme për teknikën e gdhendjes në dru ose gur.

Ushtrime:

Prisni në karton një model stampe edhe tentoni të provoni gdhendjen në dru ose në gur.

LINJAT (GUR, DRU, PIROGRAFI, BAKER)

Objektivat:

- Të njohë dhe të vlerësojë elementet dhe parimet e artit vizual si pjesë e rëndësishme e veprës.
- Të vëzhgojë, të interpretojë dhe të analizojë elementet dhe parimet e artit në çdo lloj imazhi viziv.

VIJAT (LINJAT)

Vija (linja) në kuptimin matematikor është një drejtëz lakore, planore, dhe hapësinore. Në hapësinë ajo vërtetë nuk shfaqet, por perceptohet me syrin e mendimit imagjinar dhe që merr emrin vijë (linjë). Vija në artet vizive është një përmasore. Por duke u përfshirë në një hapësinë më të gjerë ajo merr vlera dhe tri përmasore, sipas funksionit që kryen dhe vendit që zë në një vepër arti.

Pra, kur flasim për vijën në një vepër arti, duhet të njohim llojet e tyre dhe efektet emocionale që krijojnë ato. Kemi disa lloj vijash:

- të trasha (konture)
- të holla
- horizontale
- vertikale
- të pjerrëta
- të harkuara, të lakuara
- rrethore
- zik-zake
- të shkëputura detyruese, etj.

Në artet vizuale, vija paraqet një shëmbëllim grafik. Por, ç'tregojnë ato si vlera emocionale?

Horizontalja – tregon qetësi dhe siguri absolute

Vertikalja – tregon fillimin e një tensioni

Detyruesja – tregon jo stabilitetin sepse ndodhet midis horizontales dhe vertikales

Rrethorja, të thyerat , me kthesa – tregojnë se përmbajnë një forcë dinamike dhe sugjerojnë idenë e një sipërfaqeje.

Ushtrim - Realizoni një temë të lirë ku të theksohen linjat (vijat) nëpërmjet lapsit.

FORMAT

Formimi i konceptit mbi format nëpërgjithësi ka të bëjë me aftësinë për të fiksuar dallueshmërinë e formave natyrore. Konceptet mbi format natyrore rrjedhin intuitivisht në jetën e përditshme. Duke shfrytëzuar pafundshmërinë e tyre ato i ndajmë në forma gjeometrike, forma organike, forma manuale (të krijuara nga vetë njeriu).

Në format gjeometrike kemi të bëjmë me trekëndorë, rrethorë, katërkëndorë, etj të cilat kanë dhe rregulla në strukturën e ndërtimit dhe zërthimit të tyre.

Ndërsa format natyrore organike janë në variacione të pafundme. Format i ndajmë në dypërmasore dhe tripërmasore në kuptimin e përmasave (gjerësi, lartësi dhe thellësi), që ato plotësojnë. Kur njëformë plotëson dy nga këto përmasa në artet vizive quhet **dypërmasore**. Ndërsa kur i plotëson të tre përmasat quhet **tripërmasore**.

Format dypërmasore

Këto forma i kemi gjeometrike dhe manuale (të krijuara nga dora). Të gjitha format që ne vizatojmë, qofshin këto gjeometrike apo natyrore, pra piktura, grafika, vizatimi etj. Quhen dy dimensionale (dypërmasore). Në momentin që funksionon dritëhija në art ato krijojnë iluzionin e tripërmasores.

Format tripërmasore

Format tripërmasore quhen të gjitha format organike (hapësinore) që lidhen ngushtë me vëllimin. Ndërsa në vepra arti tripërmasore futet skulptura. Kjo vepër quhet tripërmasore sepse plotëson tri përmasat: lartësi, gjerësi, thellësi.

Artistët në përgjithësi duke shfrytëzuar këto pafundësi formash kanë krijuar çudira me artin e tyre, sepse aftësia për të qenë krijues në shfrytëzimin e formave të pafundme ka të bëjë me dhënien e situatave të pazakonta në art.

Ushtrim

Dru- Punoni detyrë shtëpie me plastelinë mbi një copë kompensatë një figurë sipas dëshirës për të kuptuar formën tripërmasore.

VLERA (DRITËHIJE)

Kur flasim për dritëhijen në pikturë, vizatim, grafikë, karbon etj., duhet të kuptojmë vlerën tonale të saj, si funksionon ajo brenda veprës dhe çfarë efektsh emocionale na krijon. Pra, për të kuptuar dritëhijen në përgjithësi duhet të njohim shkallën tonale të ngjyrave shumëngjyrëshe, por kjo shkallë mund të jetë dhe njëngjyrëshe (akromatike), që krijohet nga e bardha tek e zeza dhe e kundërta.

Artisti që e njeh këtë parim tonal e përdor atë me mjeshtëri në vepër dhe krijon iluzionin vëllimor të objekteve, çka i jep vlerë vizatimit.

Objekti që vizatohet ka dy lloje hijesh : hijen që e krijon vetë objekti në pjesën që nuk ndriçohet dhe hija që lëshon ai në objektin e vendosur. Trajtimi i këtyre të dyjave i japin vlerë një vepër arti.

Ushtrim:

Vizatoni në fletore një sferë me dritëhije

SIPËRFAQJA (BAKËR, PIROGRAFI, GUR, DRU)

Mundësia e të qenit së bashku e një objekti (e çdo lloji qoftë) nënkupton noncionin e strukturës. Kjo strukturë ka edhe një unitet në tërësinë e saj. Duke qenë se një objekt i çfarëdo përmase qoftë ka një strukturë lidhëse, ka njëkohësisht dhe një sipërfaqe.

Sipërfaqja është e dallueshme nga pamja e përgjithshme, por duke ndërhyrë nëbrendësi ajo ka lidhjet e veta të ndërtimit qoftë të çrregullta apo ritmike, simetrike dhe asimetrike.

Duke u nisur nga këto informacione konstatojmë se kemi disa lloj sipërfaqesh:

- të lëmuara
- të ashpra
- të përziera
- të rregullta
- të çrregullta
- natyrale
- artificiale, etj.

Ushtrim:

Bëni në shtëpi një vizatim të çfarëdoshëm me laps ku të trajtoni sipërfaqen e objektit

HAPËSIRA

Duke u nisur nga elementet dhe parimet e artit figurativ një nga të rëndësishmet është hapësira. Ajo ka një koncept të gjerë, të drejtpërdrejtë dhe nga ana figurative e pozicioneve të objekteve të hedhura në kuadër, sipas planeve dhe rëndësisë së tyre në kompozim dhe ngjyrë, sipas konceptit të qartë të autorit në punën e tij.

Konfiguracioni i natyrës dhe cilësia e dritës shërbejnë si shtytës për artistët për një përcaktim pamor të hapësirës, ku boshllëku dhe masa gjejnë vazhdimësi.

Artisti brenda shkruan në mënyrë reduktive një sasi fizike të hapësirës që e lidhin me perceptimin psikondjesor të shikuesit. Precizioni i hapësirës është i mundur edhe pse shohim dhe regjistrojmë një

imazh tjetër. Ky është në efekt që lidhet me emrin perspektivë, pasi syri ynë verifikon objekte në distancë

Ushtrim:

Bëni një vizatim në fletoren e punës me temë “Rrugë me pemë” për të kuptuar hapësirën.

THEKSI

Gjatë momentit që ne kompozojmë ndjekim disa rregulla jo strikte, por të domosdoshme dhe midis të tjerave në përfundim të veprës duhet të bjerë në sy theksi. Pra, theksi është ai fragment ose pjesë e veprës më e identifikuar që bie menjëherë në sy të shikuesit, që në kontaktin e parë të tij.

Në pikturë theksi identifikohet ose mund të shprehet me

- ngjyrën e theksuar (kontrast)
- lëvizjen interesante
- Linjën e theksuar (konturi) etj.

Në skulpturë theksi dallohet:

- nga lëvizja interesante
- pesha, masa, vëllimi, etj.

Të gjitha këto janë domosdoshmërisht në marrëdhënie me hapësirën që e rrethon, ku dritat natyrale dhe artificiale gjejnë një vazhdimësi të tyre.

Ushtrim:

Bëni një vizatim duke përdorur lapsin dhe vini në dukje theksin duke e shpjeguar me fjalë.

Realizimi i nje sofre :

Mjetet e punës: Sqepar, Sharrë, Gozhdë , Dru, Kompas

Marrim një pjesë dërrase dhe masim me të aq sa duam të bëjme sipërfaqen e sofrës. I presim me sharrë të gjitha pjesët në një masë më pas presim dy dërrasa të tjera me masën e rrezes së sofrës dhe krijojmë këmbët e sofrës duke i gdhendur me sqepar me një formë harkore të dyja këmbët e sofrës. Më pas vendosim dërrasat e prera sipër këmbëve të sofres dhe i ngjism me gozhdë në secilën dërrasë me këmbët. Pastaj vendosim një pikë në mesin e sipërfaqes së krijuar të dërrasave dhe me kompas heqim një linjë rrethore. Pas këtij procesi e presim linjën e krijuar me sharrë dhe në fund lidhim një dërrasë të ngushtë dy këmbët sofres duke i gozhduar në secilën këmbë.

Realizimi i një Mte/Dybek

Mjetet e punës: Sharrë ,Sharrë E Drejtë, Sharrë Gjysë Hark Tradicionale, Sëpatë ,Cekic, Shirit Lllamarine, Trung Peme

Marrim një masë trungu peme me rreze 14 cm dhe e presim me gjatësi 50 cm . Pastaj e gdhendim me sqepar sipërfaqen e trungut duke e mbajtur më të gjerë në pjesën ku do qëndrojë dhe më të ngushtë në pjesën e sipërme. Bëjmë ndarjen në mes të trungut duke e goditur nga lart posht me sopatë, mbasi ndajmë në dy pjesë masën gdhendim sipërfaqen e brendshme në formën gjysë rrethi të rregullt . Pastaj i bashkojmë dy format e trungut me një llamarinë rrethorenë perimetrin e trungut duke i vendos 3 ose 4 të tillë në fund në mes dhe në fillim të formës duke i shtyrë rrathët e krijuar nga lart poshtë me goditje me forcë me çekiç. Në fundin e trungut aty ku do qëndroje Mteni/Dybeku grryejm me sharrë tradicionale një kana me thellësi 5mm në rrezene trungut dhe presim një dërrasë me rreth të rregullt me perimetrin e krijuar në trung dhe e vendosim në të. Më pas presim një dërrasë të ngushtë më përmasë 3 cm me 3 cm më të gjatë se gjatësia dhe e gdhendim në mënyrë të rrumbullakët duke krijuar një shkop ku në fund të shkopit i ngjism një dërrasë rrethore e prerë në rreth të rregullt me rreze më të vogël se rrezja e brendshme e trungut.